## Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Nga perspektiva e fushës –artit, në klasën përgaditore mund të trajtohen edhe një varg çështjesh ndërkurrikulare që kanë të bëjnë me zhvillimin e qëndrueshëm, njohjen dhe

respektimin e të drejtave të fëmijëve, çështjet e barazisë gjinore, çështjet kulturore dhe ndërkulturore, parandalimi dhe luftimi i dukurive negative shoqërore etj.

P.sh trajtimi i formave e ngjyrave me qasje të barabartë si për djemtë dhe vajzat, trajtimi i rëndësisë së barabartë dhe bashkëpunimit ndërmjet elementeve figurative, trajtimi i profesioneve artistike pa dallim gjinor, fetar, racor etj

### **Ndërvarësia**

Nga perspektiva e arteve, vetë veprimtaritë artistike grupore e trajtojnë këtë temë, ngase p.sh kur duhet të realizohet nje mural, mozaik, kolazh, ose makete grupore, të gjithë pjesëmarrësit e kuptojnë që pa bashkëveprimin e secilit nuk mund të realizohet tërësia e përbashkët. Që të realizohet vetëm duke respektuar bashkëveprimin dhe ndërvarësinë.

### **Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm**

Çështjet e zhvillimit të qëndrueshëm, çështjet e realizimit të së drejtës për të jetuar në mjedis të shëndoshë dhe në mirëqenie sociale bazuar në konventat ndërkombëtare mund të jenë objekt trajtimi i punës kreative të fëmijëve edhe në këtë moshë.

Përdorimi i shprehjes artistike për të trajtuar të drejtat themelore të fëmijës për shkollim, për liri e jetë të dinjitetshme mund të realizohet shumë mirë përmes punimeve kreative etj. Përdorimi i shprehjes artistike për të trajtuar disa nga temat e zhvillimit të qëndrueshëm ( mbrojtja e ambientit, hapësirave, rregullit në klasë, në shtëpi në familje etj) bëhet p.sh duke njohur dhe përdorur materiale recikluese për të krijuar art por në të njëjtën kohë duke zhvilluar kujdes ndaj letrës, drurit, materialeve në klasë dhe ambientit të shkollës etj.

### **Udhëzimet për vlerësim**

Vlerësimi tek klasat përgatore tek fëmijët, nuk bëhet me nota, me që, qëllimi i fushës së arteve, është që të zhvilloj kreativitetin e fëmijëve dhe të nxis a të të motivojë ata, por mund me vlerësohen me fjalë motivuese, të gjithë fëmijët mund t'i dalin me sukses në kreativitet dhe artistik.

Që në këtë moshë është mirë që fëmijët të nxiten dhe të ndihmohen që të bëjnë vlerësimin të punimit të tyre, apo për performancë, etj)

## Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Përzgjedhja dhe përdorimi i mjeteve didaktike e mësimore është pjesë e pandashme e procesit të mësimdhënies, dhe ka një rëndësi të veçantë në arritjen dhe realizimin e kompetencave.

Këto mjete janë në shërbim të demonstrimit dhe konkretizimit të temave dhe njësive mësimore të trajtuara në lëndën e artit, dhe ato duhet të jenë shumë efikase, të prekshme dhe praktike për nxënësit.

Teknologjia është një nga mjetet me përdorim të gjerë në lëndën e Edukatës figurativ duke ndihmuar nxënësit të hulumtojnë dhe njohin vepra arti të ndryshme, objekte të trashëgimisë kulturore, objekte të dizajnit, etj., duke krijuar tipin studiues të nxënësve në lëndën e artit.

Shkolla si institucion arsimor, duhet të siguroj dhe ofrojë kushte dhe mundësitë tekniko-teknologjike adekuate apo alternative në realizimin dhe arritjen e kompetencave të planprogrameve të lëndëve të caktuara, në këtë rast edhe të lëndës së artit.

Në këtë formë nxënësve u krijon mundësinë të demonstrojnë apo prezantojnë me anë të medimeve teknologjike detyra dhe projekte të ndryshme.

Mësimdhënësi nxitë interesimin e nxënësve për veprimtari dhe trajtim të temave të artit duke përdorur një fjalor të pasur të gjuhës artistike figurative me fjalë dhe fjali të qarta, të sakta, kuptimore e konceptuale.

Mësimdhënësi nxitë zgjerimin e njohurive mbi artin tek nxënësit duke i motivuar që të përdorin burime, materialeve dhe tekste (Libra) të përshtatshme me moshën dhe mundësinë e nivelit të të mësuarit.

### Disa nga mjetet më të përdorshme didaktike janë:

- Materiale tekstuale: *teksti shkollor, fletore e punës, katalogë arti, albume, udhëzues profesionalë, fjalorë, gazeta, revista, materiale pedagogjike, enciklopedi etj.;*
- Mjete vizuale – figurative: *tabelë shkrimi, fotografi, piktura, , plastelinë, glinë, modele, makete, vazo, riprodhime të veprave të artit dhe postera, diagrame, mjete grafike etj.;*
- Mjedisi mësimor (*klasa, ateleja, kabineti, natyra, galeria, muzeu etj.*)  
*Burime online.*

# **Kurrikula lëndore/programi mësimor**

## **Edukatë muzikore**

### **Përmbajtja**

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

## Hyrje

Kontaktet e para me muzikën fëmija i merr në rrethin familjar që në moshë të hershme. Pas lindjes fëmija hyn në mënyrë të pa vërejtur në botën e muzikes derisa të rriturit kujdesen për të. Atyre u këndohet vazhdimisht e sidomos gjatë vënjes në gjumë. Ata janë të rrethuar me tinguj, e muzikë në rrethin ku jetojnë, dëgjojnë zërat në natyrë, onomatopetë e ndryshme ritmike dhe melodike etj. E gjithë kjo botë tingëllore mund të përdoret për edukimin muzikor në moshë të re, duke i konkretizuar këto përjetime nga jeta e përditshme me lojëra, këngë, ligjërime ritmike, lëvizje etj. Përmes aktivitetit muzikor, tek fëmijët sjellim gëzim, hare, relaksim, entuziazëm dhe në këtë mënyrë muzika ndikon direkt në pasurimin emocional të tyre, i fisnikëron ata dhe njëkohësisht ndikojmë edhe në zhvillimin e ndonjë prej aftësive muzikore për të cilën mund të kenë pre-dispozita (prirje).

## Qëllimi

Artet në klasën përgaditore kanë për qëllim që kontaktin e fëmijëve me shkollën si institucion t'ua bëjnë sa më të dashur dhe interesante përmes aktiviteteve të ndryshme artistike në të cilat ata kanë mundësi të marrin pjesë. Synimi kryesor edhe i lëndës së muzikës në këtë klasë është që fëmijët të nxiten të përjetojnë muzikën (gjatë këndimit, dëgjimit të muzikës) dhe të fillojnë të identifikon interesimet e tyre për ndonjë nga veprimtaritë apo shkathtësitë muzikore (këndim, ritmizim, lojëra muzikore, lëvizje e vallëzim, luajtje në instrumentet fëmijërore etj). Këto aktivitetet nxisin zhvillimin emocional, social, intelektin, imagjinatën, vëmendjen, interesimin për kreativitet etj.

## Temat dhe rezultatet e të nxënit

Konceptet	Temat	Rezultatet e të nxënit të lëndës për temë (RNLT)
	<b>RNF 1. Nxënësi merr pjesë në aktivitete të ndryshme artistike sipas interesimit dhe prirjes individuale</b>	
<b>Krijimtaria dhe performanca artistike</b>	Këngët  Ritmet dhe ligjërime ritmike  Meloditë Shoqërimet	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"><li>• Këndon këngë të thjeshta (në grup) sipas imitimit. <i>(Këngët trajtojnë tema të ndryshme të përshtatshme për moshën e tyre (për natyrën, shkollën, familjen, dëshirat, lodrat, stinët, festat etj)</i></li><li>• Ritmizon vargje e ritme të këngëve (me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë);</li><li>• Luan shoqërime ritmike të thjeshta ( me lodra, vegla ritmike, duartrokitje, trokitje me</li></ul>

		këmbë, laps, etj)
	Lojërat muzikore	<ul style="list-style-type: none"> <li>Luan lojëra të thjeshta muzikore të shoqëruara me këngë, të përcjellura me lëvizje trupore, e me vegla muzikore femijerore dhe që trajtojnë tema të ndryshme por edhe elemente didaktike të gjuhës artistike muzikore (ritmi, melodia, vetitë e tingullit muzikor etj)</li> <li>Luan lojëra të ndryshme ku sinkretizohet fjala, muzika, mimika, levizja, ana vizuale etj (tematika e lojërave përshtatet me tematikat nga fushat e tjera mësimore për këtë klasë)</li> </ul>
	<b>RNF2. Përmes përciptimit dhe përjetimit artistik. Nxënësi njih (vëren) elementet kryesore të gjuhës artistike përkatëse</b>	
<b>Gjuha dhe komunikimi artistik muzikor</b>	<b>Elementet shprehese të gjuhës artistike muzikore</b>  <b>Tingulli dhe vetitë e tij</b> <b>Ritmi</b> <b>Melodia</b>	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> <li>Dallon vetitë themelore të tingullit (gjatësia, lartësia, ngjyra dhe forca) përmes lojërave, këngëve dhe dëgjimit muzikor. (p.sh dallon tinguj të ulte dhe tingujt e larte, të fortë dhe të butë, të gjatë dhe të shkurtër)</li> <li>Dallon elementet themelore muzikore (ritmi, melodia dhe harmonia) në këngët, lojërat dhe veprat muzikore që ata i dëgjojnë në klasë (melodi e shpejte- e ngadalshme, lëvizje melodike lart, poshtë etj)</li> </ul>
	<b>RNF3. Nxënësi dallon relacionet e ndryshme në mes të arteve dhe shoqërisë</b>	
	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vëren dhe identifikon lloje të ndryshme të arteve (p.sh muzikën vokale, instrumentale, portreti, peisazhi etj)</li> <li>Vëren dhe identifikon llojet e institucioneve artistike (galeri, teatër, muze, salla koncertale etj.</li> <li>Emërton (rinjeh) disa (së paku 4 krijues ose artiste të njohur të gjinive e zhanreve të ndryshme të krijimtarisë artistike muzikore globale e kombëtare</li> </ul>	
<b>Muzika dhe shoqëria</b>	Llojet e muzikës	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> <li>Dallon lloje të ndryshme të muzikës përmes dëgjimit muzikor (p.sh muzike për vallëzim, muzike për film (vizatimor), muzike për fëmijë, muzikë për raste të ndryshme, muzikë festive etj)</li> <li>Njeh ndonjë institucion muzikor në vend, në qytetin/vendbanimin e tyre</li> <li>Dallon gjinitë (llojet) e ndryshme muzikore (muzikë me zë (vokale), muzikë instrumentale, muzikë me zë dhe</li> </ul>

		instrumente (vokalo instrumentale) etj
	Instrumentet muzikore	<ul style="list-style-type: none"> <li>Dallon ngjyrën tingëllore të disa prej instrumenteve kryesore muzikore (popullore dhe klasike) përmes dëgjimit të veprave muzikore të përshtatshme për moshën e tyre</li> <li>Identifikon dhe dallon instrumentet edhe me pamje.</li> <li>Krijon instrumente muzikore ritmike me materiale recikluuese dhe organike( marakas me oriz, miser, dajre te vogla etj)</li> </ul>
	Krijuesit dhe performuesit	<ul style="list-style-type: none"> <li>Identifikon ndonjë figurë markante nga krijuesit dhe performuesit artistikë botërorë dhe lokalë, veprat e të cilëve janë përdorur në dëgjimet muzikore</li> </ul>
	<b>RNF 4. Nxënësit mësojnë të çmojnë dhe vlerësojnë artin</b> <b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Shpreh reagimin personal emocional ndaj përjetimit të veprës artistike me disa fjali të thjeshta gjate bisedës dhe vrojtimit , me lëvizje,mimike, me mjete shprehëse te tjera etj.</li> <li>Çmon dhe vlerëson performancën/krijimet artistike vetanake dhe të tjerëve me fjalor shumë të thjeshtë</li> </ul>	
<b>Çmuarja dhe Vlerësimi estetik-artistik</b>	Veprat artistike Ngjarjet artistike	<ul style="list-style-type: none"> <li>Nxitet (inkurajohet) që të shpreh mendimin e vet për muziken që dëgjon me dy –tri fjali të thjeshta ose me shprehje figurative e lëvizje</li> <li>Nxitet që të shpreh mendimin e vet për krijimet dhe performimet vetanake dhe të bashkëmoshatarëve</li> <li>Përshkruan ndonjë ngjarje muzikore në familje, në shkollë dhe më gjerë</li> </ul>

## Udhëzimet metodologjike

Përzgjedhja e metodave mësimore bëhet nga mësimdhënësit në përputhje me kërkesat e shtruara me “Standardet e zhvillimit dhe të mësuarit në fëmijërin e hershme” dhe sipas “Kurrikulës bërthamë” për nivelin e parë. E rëndësishme është që mësimdhënësit duhet të krijojnë një mjedis mësimi i cili do t'i nxisë dhe do t'i ndihmojë fëmijët për të zbuluar dhe për të zhvilluar aftësitë dhe prirjet e tyre artistike.

### a) Krijimtaria dhe performanca artistike

Tek fëmijët e klasës përgaditore, këngët dhe lojërat muzikore mësohen sipas **veshit (me imitim)** dhe tematika e këngëve dhe lojërave duhet të jenë në përshtatje me moshën dhe aftësitë e tyre performuese (ambitusi, vështirësia e tekstit, e ritmit dhe posacërisht përmbajtja tekstuale me karakter edukativ dhe didaktik. Këngët dhe lojërat muzikore duhet të jenë kryesisht të zhanrit të muzikës për fëmijë por edhe ato popullore e artistike të thjeshta dhe të përshtatshme mund të përdoren. Përmbajtja tematike (tekstuale) e këngëve mund dhe duhet të korrespondojë me temat

që trajtohen nga fushat e tjera mësimore, në mënyrë të integruar, por edhe me çështjet e ndryshme ndërkurrikulare. Këngët përzgjedhen me ritme të thjeshta (vallëzuese, marshe, masa të thjeshta (2/4, 3/4, 4/4 por edhe masa të përziera 3/8 e 5/8 që përjetojnë lehtë).

Është e nevojshme që përgjatë këndimit të aplikojmë qëndrimin drejt, këndimin me emocion, shqiptimin e saktë të tekstit, synimin që të këndohet në intonacion sa më të saktë. Fëmijët inkurajohen të këndojnë kryesisht në grup në këtë fazë. Ata poashtu nxiten që të krijojnë efekte të veçanta tingujsh (imitimin e zërave të shkokëve, të instrumenteve të ndryshme), duke përdorur zërin, shkopinjë, shuplaka ose instrumente fëmijërore, të shoqërojnë ritmikisht këndimin etj.

Për edukimin e ndjenjës ritmike të fëmijëve mësindehënsi duhet t'u demonstrojë në formë konkrete dukurinë e ritmit se si përjetohe dhe me pastaj t'a zbatojmë atë në praktikë. P.sh. Dukuritë nga natyra dhe mjedisi, p.sh: të rrahurit e orës tik- tak, imitimi i trenit , rënia e ziles, rrahja e çekanit, rrahja e pulsit të dorës , rrahja e këmbanës , rrahja e daulles në një marsh etj.). Ligjërimit ritmike duhet të shoqërohen gjithnjë me lëvizje ritmike ose fjalë të ndryshme të ndara në rrokje, me duar trokitje, me shkopinjë etj. Është e këshillueshmë që elementet ritmike të përjetojnë, e të dallohen gjatë këndimit dhe të zbatohen në shoqërimin e këngëve dhe lojërave fëmijërore. Puna me instrumentet muzikore ka për qëllim njohjen e instrumentit, shton interesin për aktivitetin si dhe ndihmon drejt në edukimin e ndjenjës ritmike apo melodike. Në këtë mënyrë krijojmë modele të thjeshta ritmike ; rrahje me pëllëmb, me vegla, me goditje, krijojmë instrumente prej materjaleve recikluese me të cilat i shoqërojmë këngët por edhe me të cilat luajmë tërësi të reja muzikore (ritmike e melodike).

#### **b) Gjuha dhe komunikimi artistik muzikor**

Në këtë klasë, kryesisht dukuritë ritmike e melodike ( gjatesia e tingullit, lartësia e tingullit, ngjyra, forca) vërehen dhe dallohen kryesisht përmes lojës, mjeteve didaktike ndihëuese (fotografi, simbole, ngjyra, diagrame, etj) me të cilat lehtësohet të kuptuarit e këtyre dukurive.



### **c) Muzika dhe shoqëria**

Dëgjimi është mënyra kryesore nëpërmjet të cilës fëmija vihet në marrdhënie me muzikën. Kështu ata edhe e kuptojnë që muzika është aktivitet shoqëror, dhe sikurse që në shoqëri ka ngjarje e situata të ndryshme ka edhe lloje të ndryshme të muzikës. Këto dallime ata i vërejnë dhe i njohin vetëm përmes dëgjimit muzikor. Dallojne instrumentet me dëgjim të ngjyrës tingëllore, pamje, dhe provojnë të krijojnë edhe vetë lodra e instrumente kryesisht ritmike që i përdorin gjatë këndimit. Në atë rast ata edhe shprehin emocione që sjell kënga, vepra instrumentale etj. Mësuesi mund të përdorë metodën e krahasimit ku krahasohet një valle me një marsh, një ninullë me një muzikë vallëzimi, krahasimi i ngjyrës së zërave të shokëve , të kafshëve , instrumenteve etj. Pjesët që do të dëgjojnë kjo moshë duhet të jenë të përzgjedhura me kujdes, të jenë të thjeshta, të lehta për tu përjetuar dhe të shkurtër ( 2 – 5 minuta) por të dëgjohen sa më shpesh. Mësuesi duhet të kultivojë të dëgjuarit e muzikës sa më shumë që është e mundur, qoftë edhe kur është duke punuar në matematikë, gjuhë ose art figurativ.

### **d) Çmuarja dhe vlerësimi artistik-estetik**

Këtu mësuesi nxit vetëvlerësimin, vlerësimin e bashkëmoshatarëve dhe vlerësimin e veprave dhe të ngjarjeve muzikore me fjalor të thjeshtë duke përdorur konceptet tashmë të mësuara.

Gjatë dëgjimit të muzikës, mësuesi nxitet të shoqëroj muzikën e dëgjuar me lëvizje të përshtatshme (duke vallëzuar balet, vals, marsh etj.), të shprehet me mjete figurative ose edhe të komentojë me fjalë karakterin e veprës së dëgjuar dhe përjetimin personal që ndjen gjatë të dëgjuarit.

## **Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare**

Nga perspektiva e fushës Artet, e poashtu edhe nga lënda Edukatë muzikore, në klasën përgaditore mund të trajtohen edhe një varg çështjesh ndërkurrikulare që kanë të bëjnë me zhvillimin e qëndrueshëm, njohjen dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve, çështjet e barazisë gjinore, çështjet kulturore dhe ndërkulturore, parandalimin dhe luftimin e dukurive negative shoqërore etj.

P.sh trajtimi i formave e ngjyrave me qasje të barabartë si për djemtë dhe vajzat, trajtimi i rëndësisë së barabartë dhe bashkëpunimit ndërmjet zërave të dy gjinive në muzikë, trajtimi i profesioneve artistike pa dallim gjinor, fetar, racor etj, sjelljet në koncert, gjatë këndimit ose muzikimit të përbashkët, përgjegjësia për instrumentin etj.

### **Globalizimi dhe ndërvarësia**

Veprimtaritë artistike muzikore dhe lojërat muzikore e trajtojnë këtë temë, ngase p.sh në aktivitetet të gjithë pjesëmarrësit e kuptojnë që pa bashkëveprimin e secilit nuk mund të realizohet tërësia e përbashkët. Muzikimi në ansambël, kor, orkestër realizohet vetëm duke respektuar bashkëveprimin dhe ndërvarësinë.

### **Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm**

Çështjet e zhvillimit të qëndrueshëm, çështjet e realizimit të së drejtës për të jetuar në mjedis të shëndoshë dhe në mirëqenie sociale bazuar në konventat ndërkombëtare mund të jenë objekt trajtimi i punës kreative të fëmijëve edhe në këtë moshë.

Përdorimi i shprehjes artistike për të trajtuar të drejtat themelore të fëmijës për shkollim, për liri e jetë të dinjitetshme mund të realizohet shumë mirë përmes këngëve, punimeve kreative etj. P.sh nga materiale organike e recikluese mund të ndërtohen me ndihmën e mësimit të instrumente /vegla muzikore ritmike për “orkestrin e klasës”.

## **Udhëzimet për vlerësim**

Vlerësimi tek fëmijët parafillor nuk bëhet me nota me që qëllimi i fushës së arteve është që të zhvilloj kreativitetin e fëmijëve dhe të nxis ata e t'i motivojë ata, por nxënëit e dalluar mund të shpërblehen me vlerësime simbolike yll, zemër, diell ata që dallohen me kreativitet dhe aktivitet artistik. Që në këtë moshë është mirë që fëmijët të nxiten dhe të ndihmohen që të bëjnë vlerësimin kritik për performancën vetanake dhe të bashkëmoshatarëve të klasës duke u nxitur me pyetjet : Si ka/ke kënduar, si ka/ke vallëzuar, si ka/ke vizatuar apo modeluar etj)

### **Materialet dhe burimet mësimore**

Përzgjedhja dhe përdorimi i mjeteve didaktike e mësimore është pjesë e pandashme e procesit të mësimdhënies, dhe ka një rëndësi të veçantë në arritjen dhe realizimin e kompetencave. Këto mjete janë në shërbim të demonstrimit dhe konkretizimit të temave dhe njësive mësimore të

trajtuara në lëndën e muzikës dhe ato duhet të jenë shumë efikase, të prekshme dhe praktike për Nxënësi.

Teknologjia është shumë e rëndësishme sepse mundëson prezantimin audio-vizual të materialit të përzgjedhur muzikor për klasën përgaditore, që e bën më atraktive mësimin. Video prezantime me muzikë të përzgjedhur për moshat e tyre e me ilustrime, animacion etj mund të gjenden në internet dhe në programet educative muzikore të ndryshme me qasje on-line.

Shkolla si institucion arsimor, duhet të siguroj dhe ofrojë kushte dhe mundësitë tekniko-teknologjike adekuate apo alternative për realizimin dhe arritjen e kompetencave të parapara.

### **Disa nga mjetet më të përdorshme didaktike janë:**

Materiale tekstuale: *teksti shkollor, fletore e punës, katalogë arti, albume, udhëzues profesionalë, fjalorë, gazeta, revista, materiale pedagogjike, enciklopedi etj.;*

- Mjete auditive-dëgjimore: *radioja, magnetofoni, telefoni, kasetofoni etj.;*
- Mjete audiovizuale – *figurative-dëgjimore: televizori, filmi, videoprojektori, kasetavideo, kompjuteri, interneti, teleteksti, CD-të, DVD, e-mail-i;*
- Instrumente muzikore fëmijërore ( të Orfit, popullore, të krijuara nga fëmijët etj)  
<https://www.pinterest.com/pin/34902965838806956/>

### *Burime online*

<http://colorinmypiano.com/2010/03/19/early-childhood-online-resources/>

<https://www.preschoolprodigies.com/>

### *Video me muzike klasike për fëmijë*

[https://www.youtube.com/watch?v=1hMjxnwig0o&list=PL3WK\\_yMF5c6fF5aQNDxY\\_wEKERIEEnGY](https://www.youtube.com/watch?v=1hMjxnwig0o&list=PL3WK_yMF5c6fF5aQNDxY_wEKERIEEnGY)

[http://www.bbc.co.uk/northernireland/schools/4\\_11/music/mm/](http://www.bbc.co.uk/northernireland/schools/4_11/music/mm/)

[http://www.bbc.co.uk/northernireland/schools/4\\_11/music/mm/teachers/lessonplans.shtml](http://www.bbc.co.uk/northernireland/schools/4_11/music/mm/teachers/lessonplans.shtml)

# **FUSHA KURRIKULARE: MATEMATIKË**

**Kurrikula lëndore/programi mësimor**

Matematikë

# Kurrikula lëndore/programi mësimor

## Matematikë

### **Përmbajtja**

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

## Hyrje

Të mësuarit e matematikës në klasën përgatitore, siguron bazën për zotërimin e shprehive dhe shkathtësive matematikore dhe i përgatitë fëmijët për të qenë të suksesshëm në vitet e mëtejshme të shkollimit. Fëmijët e kësaj moshe vijnë nga mjedise të ndryshme familjare dhe me zhvillime jo të njëjtë, andaj është e rëndësishme që edhe programi i matematikës, të sigurojë një shumëllojshmëri mundësish të të nxënit përmes materialeve të përshtatshme mësimore, metodologjive adekuate të mësimdhënies për këtë moshë dhe angazhimin e përhershëm për zhvillimin e aftësive të fëmijëve.

Në klasën përgatitore, matematika, nuk duhet të konceptohet si lëndë e veçantë por si fushë e një pjese të integruar të aktiviteteve të përditshme. Është me rëndësi që fëmijët në klasën përgatitore, të edukohen, të arsimohen dhe të argëtohen përmes matematikës. Andaj, duhet bërë një lidhje e mirë e matematikës me fushat tjera, për të siguruar perceptim dhe motivim të lartë të fëmijëve, të cilët nëpërmjet lojërave të imitojnë të rriturit dhe eksperimentojnë atë që kanë parë, të mësojnë t'i zgjidhin problemet dhe të punojnë bashkërisht me të tjerët.

Nëse situatat matematikore janë të lidhura me jetën e përditshme të fëmijëve, në ambientin familjar dhe jashtë saj, atëherë ato bëjnë të mundur që fëmijët të zbatojnë atë që dinë dhe janë në gjendje të bëjnë për të zhvillojnë njohuri të reja.

## Qëllimi

Të mësuarit e Matematikës në klasën përgatitore, ka për qëllim zhvillimin intelektual të çdo fëmije, ushtrimin e rregullave themelore, kultivimin e vlerave si dhe përgatitjen për arsimin fillor.

Fusha e Matematikës për klasën përgatitore, ka qëllimet e veta specifike, përmbajtjet karakteristike dhe veprimitaritet të mësuarit, të cilat zhvillojnë tek fëmija të menduarit matematik, të komunikojnë dhe të argëtohen duke zgjidhur probleme, të paraqet konceptet elementare në mënyra të ndryshme, të fillojë të argumentojë përmes formave të ndryshme, të përgjigjet duke u bazuar në ilustrime dhe në mjete konkrete, të zbulojë ngjashmëritë, ndryshimet, rregullsitë dhe marrëdhëniet ndërmjet dukurive, të praktikojë zgjidhjen e situatave problemore që kanë lidhje me mjedisin e tyre të përditshëm.

Qëllimi i lëndës Matematikë në klasën përgatitore, është edhe *formimi matematik* i cili bëhet përmes:

- Të nxënit të integruar dhe në kontekstin e jetës së përditshme
- Të nxënit nëpërmjet lojërave krijuese që bënë fëmija.

## Temat dhe rezultatet e të nxënit

Përvetësimi i përmbajtjeve programore nga fëmija demonstrohen si njohuri relevante që atij i parashtrohen në raport me moshën. Shkathtësitë që i demonstroi fëmija përfshinë

aftësitë, zotësitë, teknikat dhe metodat për zbatimin e njohurive në arritjen e rezultateve të planifikuara për këtë klasë.

Në lëndën e matematikës për klasën përgatitore, fillojnë të zhvillohen dhe përvetësohen kryesisht këto koncepte të përgjithshme elementare matematikore:

- numrat, algjebra dhe funksioni;
- forma, hapësira, matjet dhe gjeometria;
- përpunimi i shënimeve dhe probabilitetit;

Konceptet zërthehen në tema, dhe për secilën temë janë paraqitur rezultatet e të nxënit që bazën mbështetëse e sigurojnë nga rezultatet e të nxënit për shkallën e parë kurrikulare.

Nëpërmjet situatave të thjeshta jetësore dhe lojërave të ndryshme fëmija, natyrshëm mëson konceptet bazë për numërimin, numrat deri në 10-të, krahasimin e sasive, matjet me instrumente jo standarde, kohën, modelimin, konceptet për figurat, trupat gjeometrikë, orientimin, vendndodhjen e objekteve në hapësirë dhe drejtimin.

Fëmija përmes lojës dhe objekteve konkrete kryen veprime të thjeshta të mbledhjes dhe të zbritjes, mbledhin të dhëna të zgjidhin probleme të thjeshta nga dhe për situata jetësore.

Matematika në përmbajtjen e saj përfshinë koncepte të cilat janë të mbuluara me temat përkatëse në lidhmëni me rezultatet e të nxënit të fushës (RNF), të përcaktuara në Kurrikulën Bërthamë për Klasën Përgatitore dhe Arsimin Fillor, dhe të harmonizuara me rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL).




Koncepti	Temat	Rezultatet e të nxënit të lëndës për temë (RNLT- të)
<p style="text-align: center;"><b>Numri</b></p>		<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Përdor numrat në mënyrën e vetë për të treguar sasi: tregon interes për numërimin dhe sasinë, numëron mekanikisht, numëron objektet në mënyrë të kuptueshme deri në 10.</li> <li>2. Përdor fjalë për të treguar numrin e objekteve: përdor fjalët krahasuese për numrat: më shumë/më pak, më i madh/më i vogël, po aq sa, kombinon objektet dhe përcakton se sa janë, ndan objektet dhe përcakton se sa janë, eksploron, vëzhgon pjesët e së tërës në kontekstin e jetës së përditshme.</li> <li>3. Zgjidhë problema të thjeshta sipas mënyrës së vet, duke përdorur numrat: përcakton numrin e elementeve të bashkësisë (edhe më shumë se pesë objekte), përdor korrespondencën me mënyrën 1 nga 1 për të numëruar objektet, përdor korrespondencën me mënyrën 1 nga</li> </ol>



	<p>1 për të krahasuar madhësinë e një grupi objektsh, vlerëson përfaqësimin e më pas numëron objektet për të verifikuar.</p> <p>4. Përdor treguesit numerikë: përdor vizatimin për të treguar numrat, identifikon numrat në situata të jetës së përditshme, përdor numërorët rreshtorë (i pari, i dyti, ...i fundit).</p>
<p>Numrat natyrorë</p>	<p>Fëmija:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Lexon numrat prej 1 deri në 10-të;</li> <li>▪ Numëron të paktën nga 1 deri në 10-të dhe anasjelltas me anë të mjeteve të konkretizimit;</li> <li>▪ Kopjon/vizaton, modelon numrat nga 1 deri në 10-të;</li> <li>▪ Vlerëson përmes formave të ndryshme (shikimit, të prekurit) një grup me 2-5 objekte;</li> <li>▪ Përdor numrat rreshtor për të identifikuar pozicionet në një rresht (lodrash ose objektsh - i pari- e para, i dyti- e dyta,.....i pesti-e pesta);</li> <li>▪ Krahason numrat deri në 10-të, bazuar në dy grupe objektsh dhe përdor shprehjet: më shumë, më pak, është më i madh, është më i vogël, po aq;</li> <li>▪ Radhit numrat deri në 10-të, nga më i madhi te më i vogli dhe anasjelltas duke u bazuar në objekte konkrete;</li> <li>▪ Mbledh numrat që shuma të jetë deri në 10-të, dy numra natyror duke bashkuar dy grupe objektsh;</li> <li>▪ Zbret dy numra natyrorë duke e konkretizuar me grupe objektsh;</li> <li>▪ Zgjidh probleme të thjeshta me një veprim, me mbledhje apo zbritje me numra deri 10), në situata konkrete që dalin nga jeta e përditshme e fëmijëve ;</li> <li>▪ Ndan pjesët e të tërës në kontekstin e jetës së përditshme.</li> </ul>
<p><b>Algjebra dhe funksioni</b></p>	<p>Fëmija:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Njeh marrëdhëniet në një mjedis të caktuar: krahason, klasifikon dhe rigrupon objektet duke u bazuar në një ose disa karakteristika, rendit sendet sipas cilësive të ndryshme.</li> <li>2. Përdor modelet në një mjedis, dyfishon dhe e zgjeron më tej modelin, krijon modele të thjeshta.</li> </ol>

	<p>Modelet</p>	<p>Fëmija:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Formon modele sipas vetive të objekteve;</li> <li>▪ Radhitë objekte duke zbuluar rregullin në modelin e dhënë, sipas formës, ngjyrës ose madhësisë;</li> </ul>
	<p>Bashkësitë dhe relacionet</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Klasifikon sende dhe objekte sipas disa vetive: ngjyrës, formës dhe madhësisë;</li> <li>▪ Grupon sendet dhe objektet sipas cilësive të përbashkëta;</li> <li>▪ Krahason bashkësitë duke përdorur shprehjet; më shumë, më pak, aq sa.</li> <li>▪ Shoqëron objektet (elementet) e një bashkësie të dhënë me objektet e bashkësisë tjetër;</li> </ul>
<p><b>Matjet</b></p>	<p>Fëmija:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Bënë krahasime të objekteve duke përdorur karakteristika të matshme.</li> <li>2. Përdor matjet: eksploron mënyrat e matjes, matë duke përdorur objekte.</li> <li>3. Orientohet në kohë dhe kryen renditjen në kohë të ngjarjeve që kanë të bëjnë me jetën e tyre të përditshme.</li> </ol>	<p>Fëmija:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Matë gjatësinë e objekteve të ndryshme duke përdorur njësi jostandarde (pëllëmba e dorës, shputa, hapi, lapsi, shkopinjtë etj.);</li> <li>▪ Krahason objekte sipas gjatësisë duke përdorur shprehjet: më i gjatë, më i shkurtër, po aq;</li> <li>▪ Vlerëson dhe renditë objektet sipas madhësisë, nga më i vogli te më i madhi dhe anasjelltas;</li> <li>▪ Krahason peshën e sendeve duke përdorur njësi jo standarde ( molla, topi, libri, çanta etj.);</li> <li>▪ Përdor fjalët që tregojnë periudhat kohore; ditë, natë, mëngjes, mëngjes, paradite, pasdite;</li> <li>▪ Përdor shprehjet dje, sot, nesër për të treguar ngjarje që lidhen me ditë të caktuara të javës; muajve dhe të stinëve (p.sh., të hënën luajmë me top, në mars e kam ditëlindjen etj.);</li> <li>▪ Radhit ditët e javës, muajt dhe stinët e vitit.</li> <li>▪ Përdor monedhat nga 1- 10 euro, në situata jetësore për blerje që lidhet me sasi të caktuara eurosh;</li> <li>▪ Zgjidh problema nga situata me blerje të njohura për ta;</li> </ul>

<p><b>Gjeometria hapësira dhe forma</b></p>	<p>Fëmija:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Vëzhgon pozicionet dhe vendndodhjet e objekteve, i ndan objektet veç dhe i bashkon përsëri ato, përdor veprime dhe fjalë për të treguar pozicionin dhe vendndodhjen, përdor veprime dhe fjalë për të treguar lëvizjet dhe orientimin.</li> <li>Vëzhgon format në mjedis dhe flet rreth karakteristikave të formave, përdor veprime dhe fjalë për të treguar pozicionin dhe vendndodhjen, identifikon dhe emërton disa forma, tregon kur format janë të njëjta ose të ndryshme duke përdorur një ose disa nga karakteristikat.</li> </ol>		
	<p>Orientimi</p>	<p>Fëmija:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Përshkruan vendndodhjen e një objekti, duke ju referuar një objekti tjetër ose vetes së tij dhe duke përdorur fjalë të jetës së përditshme; para - prapa, poshtë – lart, mbi – nën, majtas - djathtas, brenda – jashtë, afër – larg etj.;</li> <li>Lëvizë në drejtime të caktuara, duke u orientuar nga fjalët; para, drejt, majtas, djathtas, prapa, afër, larg, nën etj.;</li> </ul>	
	<p>Figurat gjeometrike</p>	<p>Fëmija:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Emërton figurat gjeometrike dydimensionale: katrori, trekëndëshi, rrethi dhe drejtkëndëshi;</li> <li>Krijon figurat gjeometrike dydimensionale: katrori; trekëndëshi, rrethi, drejtkëndëshi, nëpërmjet vizatimit me dorë të lirë, prerjes më gërshërë, palosjes duke përdorur materiale të ndryshme (fije peri, shkopinj etj.);</li> <li>Gjen forma ose pjesë të tyre, të ngjashme me figurat gjeometrike dydimensionale që gjenden në mjedisin përreth;</li> <li>Dallon, me anë të palosjes, vijën e simetrisë së figurave të thjeshta;</li> </ul>	
	<p>Trupat gjeometrik</p>	<p>Fëmija:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Dallon trupat gjeometrik me çosh dhe ata të rumbullakët ;</li> <li>Krahason trupat gjeometrik (përmasat e tyre);</li> <li>Identifikon objekte të ngjashme me kubin, kuboidin dhe sferën;</li> </ul>	

	Sipërfaqja	Fëmija: <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Ngjyrosë sipërfaqet brenda figurave të ndryshme (katrori, drejtkëndëshi, trekëndëshi, rrethi);</li> <li>▪ Dallon sipërfaqen brenda, jashtë dhe në figurë;</li> </ul>
<b>Të dhënat dhe probabiliteti</b>	Fëmija: <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Organizon dhe përdor informacionet e mbledhura.</li> <li>2. Bën pyetje për të mbledhur informacione, ndanë dhe klasifikon objektet në grup dhe ndonjëherë shpjegon se çfarë bashkësisht ka formuar, vlerëson informacionin për t'iu përgjigjur pyetjeve për situatat që ndodhin.</li> </ol>	
	Puna me të dhëna	Fëmija: <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Lexon të dhëna të thjeshta nga përditshmëria (p.sh., moti gjatë javës, lëvizja e veturave etj.  );</li> <li>▪ Vendosë të dhëna të thjeshta me  vizime të grumbulluara nga jeta e përditshme  ;</li> <li>▪ Parashikon mundësinë e të ndodhurit të një ngjarjeje (me dallime të mëdha );</li> <li>▪ Bën provën, e mundur, e pamundur, të sigurt.</li> </ul>

## Udhëzime metodologjike

Metodologjitë e mësimdhënies së matematikës në klasën përgatitore, bazohen në parimet e mësimdhënies të përcaktuara në Kurrikulën Bërthamë I, e cila synon një mësimdhënie që siguron kompetencat në të nxënë. Temat që paraqiten në programin e klasës përgatitore nuk mund të zhvillohen të shkëputura dhe të ndara, por ato janë të lidhura me fusha të tjera. Rezultatet e të nxënit për secilën temë shërbejnë për kërkesat dhe nocionet që synojnë edhe temat të tjera brenda fushës. Formimi matematik është një proces kompleks që kërkon një gërshetim të harmonishëm midis rezultateve të të nxënit dhe një mësimdhënie të kujdesshme që i vendos ato në funksion të njëra-tjetrës. Edukatori/ja përqendrohet kryesisht në këto aspekte:

- Lidhja e rezultateve të të nxënit të kompetencave kryesore me rezultatet e të nxënit për kompetencat e fushës dhe rezultateve të temave për klasën;
- Mësimdhënia dhe të nxënit bazuar në kompetenca;
- Mësimdhënia me fëmijën në qendër;
- Mësimdhënia dhe të nxënit e integruar.

## **Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare**

Nga perspektiva e fushës së Matematikës, në klasën përgatitore, mund të trajtohen edhe një varg çështjesh ndërkurrikulare që kanë të bëjnë me zhvillimin e qëndrueshëm, njohjen dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve, çështjet e barazisë gjinore, çështjet kulturore dhe ndërkulturore, parandalimi dhe luftimi i dukurive negative shoqërore, etj.

Matematika është e lidhur ngushtë me shumë komponentë të tjera që fillon në formimin e personalitetit të fëmijës përmes temave të ndryshme si; ngrohja globale, burime të përhershme e të pashtershme, njohja e kulturave, zhvillimi i qëndrueshëm, bashkëjetesa paqësore, planifikimi i buxhetit, etj.

Fëmija inkurajohet të zhvillojë marrëdhënie aktive në mjedisin duke ruajtur një qëndrim kritik ndaj mallrave të konsumit.

Fëmija përdor aftësitë e tij matematikore që kanë të bëjnë me simbole, vizatime, grafikë për të zhvilluar marrëdhënie aktive në mjedisin e tij. Ai mund të shpjegojë fenomenet në botën e tyre dhe ndërvarësitë e mjedisit dhe botës njerëzore.

## **Udhëzime për vlerësim**

Në përputhje me parimet e qasjes së të nxënit bazuar në kompetenca, vlerësimi për këtë klasë konsiderohet si element i cili përqendrohet në nivelin e zhvillimit të shkathtësive dhe përmbushjes së kompetencave. Vlerësimi tek fëmijët nuk bëhet me nota por si qëllim ka të zhvillojë kreativitetin e fëmijëve, të nxis dhe të motivojë ata. Ata mund të shpërblehen me vlerësime simbolike yll, zemër, diell, etj., që dallohen me kreativitet në zhvillim të aktiviteteve.

Vlerësimi i arritjes së fëmijëve në Klasën përgatitore në Matematikë, realizohet nëpërmjet evidencës së vlerësimit të vazhdueshëm, vëzhgimi, vlerësimi përmes portofolit, ndërsa raportimi i të arriturave bëhet përmes përshkrimeve me komente konstruktive.

## **Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore**

Gjatë mëimit të Matematikës, edukatori/ja, jep informacione dhe performon shkathtësi në përmbushje të rezultateve duke përdorur materiale didaktike dhe burime të nevojshme, ndërsa fëmija gjeneron informacione, formon dhe zhvillon shkathtësi duke iu qasur të mësuarit përmes të pamjes, të dëgjuarit, të prekjes dhe formave të tjera për arritje të rezultateve.

Për përmbushjen e kompetencave të nivelit të parë të Arsimit fillor për Klasën përgatitore, edukatori/ja siguron qasje përmes përdorimit të materialeve të përshtatshme me moshën dhe mundësinë e nivelit të të mësuarit.

Materialet që mund të përdoren për tema nga Matematika: materiale të riciklueshme; petëza; tabela magnetike; grafikë të numrave; kuti me forma të ndryshme; figura gjeometrike me forma dhe ngjyra të ndryshme; fije shkrepe; shkopinj didaktikë; fleta me dhe pa ngjyra; lapsa; numëratore me gogla; lapsa me ngjyra, tabela për regjistrimin e të dhënave; vargje me gogla; fletëpalosje për të lidhur numrin me sasinë; lodra të ndryshme; kuba; trupa gjeometrik si dhe mjetet teknologjike me programe matematikore për fëmijë.

**FUSHA KURRIKULARE: SHKENCAT E  
NATYRËS**

**Kurrikula lëndore/programi mësimor  
Njeriu dhe natyra**

# **Kurrikula lëndore/programi mësimor**

## **Njeriu dhe natyra**

### **Përmbajtja**

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

## Hyrje

Fusha kurrikulare Shkencat e natyrës në shkallën e parë mësohet nga fëmijët përmes lëndës Njeriu dhe natyra, e cila integron njohuritë, të kuptuarit, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat nëpërmjet disiplinave: biologji, gjeografi, fizikë dhe kimi.

Lënda Njeriu dhe natyra në klasën parafillore u mundëson fëmijëve që në mënyrë aktive të njohin dhe hulumtojnë botën përreth tyre, të provojnë gjëra për të parë se çfarë do të ndodhë, të dallojnë karakteristikat fizike të objekteve dhe materialeve, karakteristikat e botës së gjallë, ndryshimet klimatike, ndryshimet në Tokë, zgjedhin dhe përdorin mjete dhe materiale të ndryshme për të zgjuar interesimin dhe kërshtërinë e fëmijëve.

Përmes kësaj lënde kontribuojmë që fëmijët të arrijnë kompetencat e synuara sipas Kurrikulës Bërthamë për shkallën e I-rë kurrikulare, në arritjen e rezultateve të nxënies të fushës dhe rezultateve të nxënies të lëndës.

Detyrë e mësimit të lëndës Njeriu dhe natyra është zhvillimi i shprehive të vëzhgimit, hulumtimit, të menduarit kritik, kreativitetit, nxitja e pikëpamjeve të hapura dhe motivimin e fëmijëve për të mësuar.

## Qëllimi

Qëllimet e të mësuarit të lëndës Njeriu dhe natyra janë:

- Zhvillimi i njohurive dhe të kuptuarit e koncepteve shkencore dhe teknologjike përmes hulumtimit të proceseve biologjike, fizike dhe kimike në mjedis.
- Zhvillimi i qasjes shkencore që ndihmon të kuptuarit dhe të menduarit kritik e krijues.
- Inkurajimi i fëmijëve të njohin, të hulumtojnë, të zhvillojnë dhe zbatojnë idetë dhe konceptet shkencore përmes lojërave, vizatimeve dhe aktiviteteve praktike.
- Inkurajimi i fëmijëve të vlerësojnë kontributin e shkencës dhe teknologjisë në përditshmëri.
- Kultivimi i kujdesit dhe respektit për diversitetin e botës së gjallë, mjedisit fizik dhe varësinë e bashkëveprimit në mes tyre.
- Inkurajimi i fëmijëve për ngritjen e përgjegjësisë për të mbrojtur, përmirësuar dhe dashur mjedisin duke u involvuar në identifikimin, diskutimet dhe aktivitetet për problemet mjedisore që të promovojnë zhvillimin e qëndrueshëm.
- Gatishmëria e fëmijëve për të komunikuar në mes veti idetë dhe të gjeturat nga vëzhgimet dhe vizitat në natyrë.



## Temat dhe rezultatet e të nxënit

Përmbajtja e lëndës Njeriu dhe natyra është e bazuar në konceptet e fushës kurrikulare Shkencat e natyrës, temave dhe rezultateve të të nxënit të lëndës (RNL) në përputhje me qëllimet e saj. Lënda Njeriu dhe natyra në përmbajtjen e saj përfshinë katër koncepte (shiko tabelën më poshtë), të cilat janë të mbuluara me temat përkatëse në lidhmëri me rezultatet e të nxënit të fushës (RNF) dhe të harmonizuara me rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL).

Temat kanë lidhshmëri horizontale me konceptet dhe lidhshmëri vertikale me rezultatet e të nxënit të fushë (RNF-të) dhe me rezultatet e të nxënit të kompetencës (RNK) të shkallës së parë të kurrikulës të përcaktuar në Kurrikulën bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor.

Konceptet	RNF: Vrojtton, përshkruan dhe krahason materialet, sipas origjinës, përbërjes, vetive, madhësisë, formës, shndërrimeve dhe përdorimit në jetën e përditshme	
	Temat	Rezultatet e të nxënit të lëndës për temë (RNLT)
Materia, vetitë dhe shndërrimet	Materialet dhe vetitë e tyre	<ul style="list-style-type: none"> <li>Dallon lodrat dhe objektet e rrethinës së vet, sipas ngjyrës, formës, madhësisë, peshës, fortësisë dhe temperaturës.</li> <li>Përshkruan materialet/objektet sipas ngjyrës, formës, fortë/butë, lëmuar/ashpër</li> <li>Grupon lodrat dhe objektet që disponon përreth sipas ngjyrës, formës, peshës, fortësisë dhe temperaturës.</li> <li>Hulumton material nga objektet e njohura për ta (letër, dru, metal, plastikë, tekstil, shkëmbinjë etj).</li> <li>Diskuton për përdorimin e materialeve të cilat përdoren në jetën e përditshme;</li> </ul>
Bota e gjallë	RNF: Vrojtton dhe përshkruan karakteristikat themelore dhe nevojat jetësore të njeriut dhe qenieve të tjera të gjalla, llojlojshmërinë biologjike, ndërveprimin e organizmave me mjedisin natyror si dhe rritjen dhe zhvillimin e tyre në mjedisin natyror	
	Përshkruan rëndësinë e përdorimit të llojlojshmërisë dhe sasisë së ushqimit të shëndetshëm, si dhe kujdeset për higjienën personale	
		<ul style="list-style-type: none"> <li>Dallon pjesët kryesore të bimëve.</li> <li>Tregon nevojat themelore jetësore të bimëve</li> </ul>

	<p><b>Bimët kafshët dhe njeriu.</b></p>	<p>(ushqim, ujë, ajër, dhe dritë).</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përshkruan shfrytëzimin e bimëve (për ushqim te shtazëve, e të njeriut.) dhe për zbukurime.</li> <li>• Tregon nevojat themelore jetësore të kafshëve (strehim, ushqim, ujë, ajër, dhe dritë).</li> <li>• Përshkruan lidhjen reciproke në mes shtazëve dhe njeriut.(ushqim, veshmbathje dhe kujdes).</li> <li>• Dallon pjesët kryesore të trupit të njeriut.</li> <li>• Dallon shqisat e njeriut dhe te kafshëve .</li> <li>• Realizon veprime duke përdorur shqisën e caktuar (të pamurit, dëgjuarit, nuhatjes, shijimit dhe prekjes).</li> <li>• Tregon nevojat themelore jetësore të njeriut (strehim, ushqim, ujë, ajër, dhe dritë).</li> <li>• Dallon ndryshimet që pëson trupi i njeriut gjatë viteve.</li> </ul>
<p><b>Proceset fizike</b></p>	<p><b>RNF: Dallon gjendjen e qetësisë nga gjendja e lëvizjes së trupave, përshkruan lloje të ndryshme të lëvizjeve duke i vendos në lidhmeri me veprimin e forcave.</b></p> <p><b>Identifikon burimet e ndryshme të energjisë (duke përfshirë rolin e nxehtësisë së Diellit për jetën në Tokë) për shfrytëzimin efikas të tyre për jetën e njeriut.</b></p>	
	<p>Trupat dhe lëvizjet e tyre</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Dallon trupat në qetësi nga trupat në lëvizje.</li> <li>• Tregon disa trupa që janë në qetësi dhe disa të tjerë që janë në lëvizje</li> <li>• Dallon trupin më të shpejtë nga trupi më i ngadalshëm.</li> <li>• Dallon trupin më të nxehtë nga trupi më i ftohtë.</li> <li>• Identifikon trupin më shumë të ndritshëm, nga trupi më i zbehtë, ( psh. llampën nga qiriu etj)</li> <li>• Identifikon gjatë këndimit, zërin më të lartë nga zëri më i ulët.</li> <li>• Dallon trupin e rëndë nga trupi më i lehtë .</li> <li>• Identifikon sipërfaqen më shumë të lëmuar nga sipërfaqet tjera më pak të lëmuara, (fërkimi)</li> <li>• Tregon rrjedhën kohore të ngjarjeve ndaj së djeshmës, sotmes, të nesërmës dhe gjate ditës.</li> </ul>
<p><b>Toka, mjedisi dhe gjithësia</b></p>	<p><b>RNF: Identifikon mënyrat e orjentimit dhe lëvizjet në hapësirë, dhe tregon forma të thjeshta të bashkëveprimit në relacionin njeri-natyrë, dallon disa nga llojet e ndotjes së mjedisit që shkaktohen nga faktorë të ndryshëm në rrethin ku jeton e më gjerë, tregon për rolin që ka në ruajtjen e mjedisit dhe ndërmerr veprime të dobishme që promovojnë mjedisin e pastërt</b></p>	

	<b>Përshkruan veçoritë e elementeve natyrore të mjedisit natyror (relievin, klimën, ujërat, botën bimore dhe shtazore).</b>	
	<b>Toka dhe hapësira</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Dallon ditën dhe natën dhe lidh kohën e ditës me aktivitetet vetanake dhe obligimet familjare.</li> <li>• Tregon karakteristikat themelore të stinëve gjatë vitit;</li> <li>• Përshkruan ndryshimet e motit gjatë stinëve të vitit.</li> <li>• Tregon burime të ndryshme të energjisë</li> <li>• Emërton pjesë të relievit të mjedisit ku jeton. (male, fusha, kodra, lumenj dhe liqene);</li> </ul>

## Udhëzime metodologjike

Për realizimin e përmbajtjes së lëndës Njeriu dhe natyra, qoftë të aktiviteteve kurrikulare dhe jashtë kurrikulare, në arritjen e kompetencave, edukatore, mësuesi/ja përzgjedh metodat, teknikat dhe format e nevojshme në përshtatje me nevojat dhe mundësitë e nxënësve në linjë me realizimin e rezultateve të pritshme në kontekst të filozofisë dhe parimeve të KKK-së.

Edukatoria, mësuesi/ja përdor mjete, materiale dhe prova të ndryshme në bazë të kërkesave që dalin nga mosha dhe aktiviteti që do të realizohet për njësinë e caktuar mësimore.

Lënda: Njeriu dhe natyra kërkon nga edukatoria, mësuesi/ja që të jetë më shumë në rolin e drejtuesit duke përdorur qasje krijuese, gjithëpërfshirëse, ndërvepruese dhe ekipore.

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave për nxënie cilësore, sugjerohen qasje metodologjike si më poshtë:

- Mësimdhënie e drejtëpërdrejtë (shpjegim, sqarim, ushtrime praktike dhe shembuj);
- Mësimdhënie jo e drejtëpërdrejtë (vëzhgim, hulumtim, zgjidhje e problemeve);
- Mësimdhënie me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar fëmijëve);
- Diskutimi dhe të nxënësve në bashkëpunim ( në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë fëmijët);
- Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve;
- Mësimdhënie përmes vrojtimit, demonstrimit dhe provës;
- Mësimdhënie dhe të nxënësve përmes mjeteve multimediale;
- Mësimdhënie që nxit hulumtimin e pavarur përmes projekteve, punëve kërkimore në terren;
- Mësimdhënie dhe të nxënësve në natyrë dhe vizitat në objekte industriale.

Edukatore, mësuesi/ja i udhëheq fëmijët, ashtu që ata me aktivitetet e tyre në klasë, shkollë, natyrë etj., mund të: njohin, vrojtojnë, radhisin, masin, shënojnë, mbledhin të dhënat, provojnë,

mendojnë në mënyrë të pavarur si dhe japin mendimet e tyre, por duke u nisur gjithmonë nga parimet didaktike: *prej të njohurës kah e pa njohura, prej të afërmes kah e largëta, prej të thjeshtës kah e përbëra, prej konkretes kah abstraktja, prej të veçantës kah e përgjithshmeja.*

## **Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare**

Temat ndërkurrikulare që mund të integrohen në Kurrikulën e shkencave të natyrës për këtë moshë të nxënësve janë:

- **Edukimi për media;**
- **Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm**

### **Edukimi për media**

I referohet njohjes së llojeve të mediave që shpërndajnë e informacione të reja dhe të sakta, për hulumtimet dhe zbulimet e reja shkencore. Çështja e edukimit për media përfshinë përmbajtjet lidhur publikimet, shpërblimet për të arriturat në shkencë në nivelin kombëtar dhe ndërkomëbëtarë

### **Arsimimi për zhvillim të qëndrueshëm**

I referohet temave me rëndësi të përgjithshme të cilat ndikojnë në formësimin e fëmijëve për një qëndrim të ndërgjegjshëm ndaj çështjeve në vetëdijësimin dhe ruajtjen e pasurive natyrore, në nivel shkolle dhe mjedisit ku jeton. Këtu hyjnë çështjet si : aspekti social, ekonomia familjare, riciklimi etj.

Çështjet e zhvillimit të qëndrueshëm përfshijnë aspektet për të pasur mjedis të shëndetshëm që ndërlidhet me vetëdijësimin dhe rëndësinë e shfrytëzimit të burimeve mjedisore si trashëgimi e brezit të ardhshëm.

## **Udhëzime për vlerësim**

Vlerësimi është proces i grumbullimit sistematik, cilësor e sasior të informatave të arritjes së nxënësve gjatë procesit të të nxënësve dhe nxjerrja e gjykimeve për to.

Vlerësimi i nxënësit mbështetet në rezultatet e të nxënësve të programit lëndorë dhe shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve në lëndën Njeriu dhe natyra.

Metodat e vlerësimit që duhet të përdoren në shkencat e natyrës:

- Vlerësimi me gojë (diskutime, debate, prezantime)
- Vlerësimi i punës praktike/eksperimentale
- Vlerësimi individual dhe grupor gjatë lojës/punës kërkimore
- Lista kontrolli
- Portfolio

Edukatore, mësuesi\ja për shkak të specifikave që ka lënda, duhet të përdorin sa më shumë instrumente vlerësuese, ku secili instrument vlerësues të ketë një standard dhe të jetë i specifikuar me kritere të hartuara nga vetë edukatoria, mësuesi\ja, në harmoni me politikat arsimore.

Edukatore, mësuesi\ja harton planin vjetor për vlerësimin e nxënësve, i cili plan duhet të miratohet nga gjitha grupet e interesit (aktiviteti profesional, drejtorja e shkollës, nxënësit dhe prindërit).

Vlerësimi i mbrendshëm i fëmijëve bëhet sipas UA për vlerësim.

## **Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore**

Për realizimin me sukses të kompetencave dhe koncepteve kryesore në shkencat e natyrës është e nevojshme të krijohen kushte, të sigurohen mjete mësimore dhe mjedis i përshtatshëm mësimor për klasën parapërgatitore.

Si burim i informacionit përveç pakos shkollore është e domosdoshme të përdoren edhe burime të tjera si CD (filma, dokumentarë, video eksperimente etj), interneti (fotografi, programi instruktivë, video etj.), enciklopedi, atllase etj.

Për të rritur interesimin dhe kureshtjen e fëmijëve është e domosdoshme të përdoren mjete të ndryshme si: tabela digjitale,(tabela\SMART\ e mençur) fotografi, piktura, modele, makete, televizori, videoprojektori, kompjuteri, telefoni, tableti etj.

Për arritje të rezultateve në shkencat e natyrës është e domosdoshme sigurimi i mjedisit të përshtatshëm mësimor. Sipas mundësive përveç klasës, mësimi duhet të zhvillohet edhe në mjedise të tjera (laborator, punëtori, natyrë, ferma, ndërrmarrje etj.).

# **FUSHA KURRIKULARE: SHOQËRIA DHE MJEDISI**

**Kurrikula lëndore/programi mësimor**  
Shoqëria dhe mjedisi

# **Kurrikula lëndore/programi mësimor**

## **Shoqëria dhe mjedisi**

### **Përmbajtja**

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

## Hyrje

Lënda Shoqëria dhe Mjedisi, për klasën përgatitore, luan rol të rëndësishëm në zhvillimin e njohurive, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve të fëmija. Përmes kësaj lënde, fëmija do të ketë mundësi të kuptoj raportet me të tjerët duke filluar nga familja e më gjerë.

Kjo lëndë i mundëson fëmijës ta konceptojë hapësirën e banimit, ku jeton, raportet ndërpersonale në familje, në shkollë e më gjerë. Lënda Shoqëria dhe Mjedisi do t'i zgjeroj njohuritë rreth zhvillimeve në lagjen ku jeton me bashkëmoshatarët dhe personat e tjerë me të cilët e ndan hapësirën e banimit dhe të veprimit p.sh., rreth kujdesit për mjedisin, organizimeve të ndryshme, si dhe vendimeve të cilat i merr ai dhe të tjerët.

Njohuritë e kësaj lënde i mundësojnë fëmijës që të mësojë për të jetuar së bashku me të tjerët, të kultivoj identitetin e tij, njëkohësisht dhe kujdesin për zhvillim të qëndrueshëm.

## Qëllimi

Qëllimi i kësaj lënde në këtë klasë, është që të nxis fëmijën të eksploroj mjedisin shoqëror që e rrethon, për të njohur më mirë vetveten, familjen, bashkësinë dhe mjedisin jetësor. Po ashtu, të fitoj njohuri për rregullat e jetës kolektive, shkathtësi elementare për të marr vendime të thjeshta në situata të përditshme jetësore, që të kultivoj respektin dhe kujdesin ndaj vetes, të tjerëve dhe mjedisit, në mënyrë që të bëhet qytetar i përgjegjshëm.

## Temat dhe rezultatet e të nxënit

Fëmijët në klasën përgatitore i arrijnë rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL) për temat e përcaktuara në tabelën e mëposhtme, të dalta nga rezultatet e të nxënit të fushës (RNF) Shoqëria dhe Mjedisi, të shkallës së parë (Shk 1) të Kurrikulës Bërthamë për Klasën Përgatitore dhe Arsimin Fillor:

<b>Koncepti</b>	<b>RNF, TEMA dhe RNL</b>
<b>Individi, grupet dhe marrëdhëniet shoqërore</b>	<b>RNF: 1. Mëson për vetveten, strukturën e grupeve shoqërore dhe mënyrat e përfshirjes në to</b>
	1.1 Tregon (rrëfen) për vetveten, familjen e ngushtë dhe të gjerë (dallon moshën dhe prejardhjen), rrethin ku jeton e vepron si dhe organizimin e hapësirës së banimit dhe veprimit, migrimet, vendbanimet dhe veprimtaritë ekonomike.  1.2 Dallon disa aspekte të shprehjes së identitetit personal dhe grupor, si: fizik, psikologjik, emocional, social, kulturor, administrativ, me qëllim ndërlidhjeje me të tjerët, pavarësisht dallimeve.
	<b>Tema</b> <b>Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)</b>



	Unë dhe të tjerët	<p>Fëmija:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përshkruan veten duke përdorur disa prej karakteristikave të tij bazë (p.sh.emri, mbiemri, gjinia, mosha, ngjyra e flokëve dhe e syve).</li> <li>• Tregon për anëtarët e familjes së ngushtë dhe të gjerë p.sh.emri, mbiemri, gjinia, mosha, profesionin etj).</li> <li>• Tregon pozitën e tij në raport me të tjerët si fëmijë-prind, nip/mbesë-gjysh/ gjyshe, motër-vëlla etj.</li> <li>• Dallon familjen e tij të ngushtë nga ajo e gjerë për nga numri dhe afërsia farefisnore.</li> <li>• Përshkruan emocionet e veta për dhe në situata të ndryshme jetësore.</li> <li>• Identifikon gjërat që mund t'i bëj vetë dhe ato për të cilat i nevojitet ndihmë ose shoqërim nga të tjerët.</li> <li>• Dallon ndryshimet, si: mosha, gjinia dhe të përbashkëtat që janë ndërmjet tij dhe të tjerëve në familje dhe shoqëri.</li> <li>• Identifikon njerëzit të cilët kanë nevojë për ndihmë dhe tregon gatishmëri për t'i ndihmuar ata.</li> </ul>
<b>Proceset shoqërore dhe natyrore</b>	<p><b>RNF: 2. Njeh rëndësinë e monumenteve, dukurive, proceseve historike, shoqërore, natyrore e mjedisore si dhe lidhjet dhe ndikimet ndërmjet tyre</b></p> <p>2.1. Përshkruan ngjarje shoqërore, kulturore dhe historike si dhe dukuri natyrore e mjedisore përmes shembujve nga jeta e përditshme dhe nga e kaluara.</p> <p>2.2. Kupton proceset dhe dukuritë e ndryshme shoqërore dhe natyrore dhe ndërvarësinë e njeriut me natyrën.</p>	
	<b>Tema</b>	<b>Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)</b>
	Vendi/ mjedisi ku jetoj	<p>Fëmija:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përshkruan në forma të ndryshme shprehëse vendin ku jeton.</li> <li>• Merr pjesë në organizime të ndryshme familjare dhe shoqërore dhe përshkruan në forma të ndryshme ngjarjet dhe përjetimet e tij.</li> <li>• Identifikon shërbimet që i ofrohen në familje, lagje/ kopsht/shkollë, mjedisin rrethues (kujdesin prindëror, shërbimet mjekësore dhe rekreative, etj).</li> <li>• Tregon për profesionet e anëtarëve të familjes dhe të personave që njeh.</li> </ul>
<b>Normat, të drejtat dhe përgjegjësitë</b>	<p><b>RNF: 3. Njeh dhe mëson të zbatojë normat dhe rregullat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet</b></p> <p>3.1. Identifikon dhe respekton traditat dhe festat si pasqyrim i llojllojshmërisë</p>	

	<p>kulturore, fetare, shoqërore, etnike e familjare.</p> <p>3.2. Merr pjesë në caktimin e rregullave për jetën personale (kohën e punës, argëtimit, vizitave, pushimit dhe gjumit), rregullave të familjes, të shkollës dhe grupeve ku ai është i përfshirë dhe u përmbahet atyre.</p>
<b>Tema</b>	<b>Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)</b>
Festat	<p>Fëmija:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Emërton disa nga festat familjare dhe shoqërore dhe në mënyrën e vet përshkruan organizimin dhe manifestimin e tyre.</li> </ul>
Unë dhe rregullat	<ul style="list-style-type: none"> <li>Dallon rregullat e caktuara në veprimtari të ndryshme që zhvillohen në familje, klasë, shkollë/kopsht, lojë etj.</li> <li>Vendos rregulla të thjeshta, në bashkëpunim me të tjerët, në veprimtaritë e tij të përditshme.</li> <li>Zbaton rregullat për veprimtari të caktuara në situata të ndryshme jetësore si në familje, lagje, kopsht/shkollë, rrugë/ komunikacion, etj</li> </ul>
Përgjegjësitë e mia	<ul style="list-style-type: none"> <li>Tregon për fjalët, sjelljet dhe veprimet e veta në raport me të tjerët dhe merrë përgjegjësi për to.</li> </ul>
<b>Vendimmarrja dhe institucionet</b>	<p><b>RNF: 4. Përfshihet në dhënien e ideve, propozimeve dhe merr vendime në mënyrë të përgjegjshme</b></p> <p>4.1. Demonstron vetëbesim dhe merr vendime për çështje që lidhen me situata nga jeta e përditshme, në përputhje me moshën si individ dhe si anëtar i një grupi (familja, shkolla, etj.)</p>
<b>Tema</b>	<b>Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)</b>
Unë vendos për veten time	<p>Fëmija:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Identifikon vendime të cilat mund t'i marrë për veten e tij, në raport me moshën.</li> <li>Merr vendime të thjeshta për situata të ndryshme jetësore.</li> <li>Argumenton në mënyrën e vet vendimet e tij/saj gjatë lojës dhe aktiviteteve të tjera të përditshme (luaj futboll sepse me pëlqen, luaj basketboll pasi po luajnë edhe shokët e mi etj).</li> </ul>
<b>Mjedisi, resurset dhe zhvillimi i qëndrueshëm</b>	<p><b>RNF: 5. Kontribuon në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit si dhe në zhvillimin e qëndrueshëm</b></p> <p>5.1. Njeh dhe dallon disa nga llojet e ndotjes së mjedisit që shkaktohen nga faktorë të ndryshëm, në rrethin ku jeton dhe kupton rolin që ka në ruajtjen e mjedisit.</p> <p>5.2. Kupton ndërlidhjen e mirëqenies personale e shoqërore në raport me kujdesin ndaj mjedisit.</p>

	<b>Tema</b>	<b>Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)</b>
	Kujdesi për mjedisin rrethues	<p>Fëmija:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Identifikon disa nga ndotësit e mjedisit dhe demonstroi shkathhtësi të kujdesit ndaj mjedisit që e rrethon (familje, shkollë /kopsht, lagje etj.)</li> <li>• Identifikon sjelljet që lidhen me mbrojtjen dhe dëmtimin e mjedisit.</li> <li>• Tregon mënyrat e sjelljes (të drejtë dhe të gabuar) për kujdesin ndaj mjedisit në rrugë, lagje, park etj.</li> <li>• Diskuton për mënyrat e udhëtimit dhe ndikimin e tyre në mjedisin rrethues (transporti publik dhe privat).</li> </ul>

## Udhëzime metodologjike

Për arritjen e rezultateve të parapara në programin e lëndës Shoqëria dhe Mjedisin për klasën përgatitore, përdoren një varg metodash dhe teknikash të mësimdhënies.

Strategjitë, metodat dhe teknikat që shërbejnë për arritjen e rezultateve tek fëmija, bëhen në bazë të organizimit të mirë të punës në shkollë, dhe jashtë saj. Kjo arrihet duke përdorur qasje ndërvepruese dhe gjithëpërfshirëse, forma të shumëllojshme të punës duke respektuar moshën, personalitetin dhe stilet e ndryshme të të nxënit. Mësimdhënësi/ edukatori-ja duhet të kujdeset edhe për qasjen e mësimin të diferencuar. Për të arritur këtë qëllim zbatohet një kompleks i tërë procedurash, si: lojëra të ndryshme, ushtrime, punë individuale e grupore, detyra, demonstrime, punë me projekte, e të tjera.

Duke pasur në konsideratë specifikat e lëndës, preferohet që të përdoret loja në përgjithësi dhe loja me role në veçanti, e cila krijon shprehje të komunikimit efektiv, shkathhtësi të të menduarit kreativ, aftësi bashkëpunuese dhe socializim.

I gjithë organizimi bëhet duke pasur parasysh zhvillimin psikofizik, intelektual dhe kulturor të fëmijës, qasjen e integruar, çështjet ndërkurrikulare dhe jashtëkurrikulare dhe rezultatet e të nxënit të kompetencave të parapara për shkollën e parë kurrikulare në Kurrikulën Bërthamë për Klasën Përgatitore dhe Arsimin Fillor të Kosovës. Për realizimin e programit të kësaj lënde kërkohet të bashkëpunohet me familje, me institucionet si kopshtin/ shkollën, bashkësinë, mediet dhe shoqërinë civile.

Mësimdhënësi gjatë realizimit të lëndës Shoqëria dhe Mjedisin duhet të ketë parasysh qasjen e integruar të mësimdhënies, pra duhet të realizohet duke u kombinuar me lëndët tjera mësimore.

## **Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare**

Çështjet ndërkurrikulare janë çështje/tema të veçanta që duhet të ndërlidhen me rezultatet e fushës dhe lëndës. Atyre duhet t'ju kushtohet vëmendje e trajtim adekuat edhe përmes lëndës Shoqëria dhe Mjedisi. Nga edukatori/ja kërkohet që në fazën e planifikimit të analizojë rezultatet e fushës, rezultatet e lëndës, temat dhe njësitë mësimore dhe të parasheh se me cilat çështje ndërkurrikulare, të përcaktuara në kurrikulën bërthamë, ndërlidhen. Në këtë mënyrë sigurohet trajtimi i këtyre çështjeve duke marrë parasysh edhe mësimdhënien e integruar.

Çështjet ndërkurrikulare, të parapara me kurrikulën bërthamë, që duhet të trajtohen, janë:

- Edukimi për qytetari demokratike
- Edukimi për paqë
- Globalizimi dhe ndërvarësia
- Edukimi për media,
- Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

Për klasën përgatitore, temat thjeshtësohen duke pas parasysh moshën dhe mundësitë e fëmijëve. Gjatë trajtimit të temave të ndryshme p.sh Kujdesi për mjedisin rrethues, edukatori kontribuon në çështjen ndërkurrikulare “Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm”. Përmes aktiviteteve për ndarjen e mbeturinave të plastikës, letrës dhe të tjera, fëmijët kuptojnë se hudhja e mbeturinave të plastikës dëmton mjedisin më shumë se mbeturinat e letrës. Udhëtimet me disa automjete e ndotin ajrin, derisa ngasja e biçikletës nuk e ndot ajrin dhe ndikon pozitivisht në shëndetin e njeriut. Pastaj, p.sh. zgjidhja e konflikteve duke biseduar kontribuon në çështjen “Edukimi për paqen”. Shembujt nga komunikimi i shpejt përmes internetit apo veshmbathja dhe ushqimet nga vendet e ndryshme, e të tjera si këto, kontribuojnë në çështjen “Globalizimi dhe ndërvarësia”. Marrja e përgjegjësisë, respektimi i mendimeve të të tjerëve, etj kontribuojnë në çështjen “Edukimi për qytetari demokratike”. Përdorimi i materialeve dhe programeve elektronike dhe të shkruara për fëmijë, përdorimi i drejtë dhe i sigurt nga nxënësit-kontribuojnë në “Edukimin për media”. Kështu, në kontekste të ndryshme mund të përdoren shembuj të ndryshëm për të trajtuar çështjet ndërkurrikulare në kuadër të lëndës Shoqëria dhe Mjedisi.

## **Udhëzime për vlerësim**

Vlerësimi bëhet me qëllim të përcjelljes së progresit të nxënies së fëmijës dhe reflektimit në mësimdhënie. Ai është i ndërlidhur me metodologjinë e mësimdhënies, me planifikimin dhe kërkon pajtueshmëri dhe konsistencë në gjithë procesin mësimor. Edukatori-ja duhet të harmonizojë vlerësimin me atë që ka planifikuar, synuar, ta arrijë tek fëmija duke u mbështetur në programin e lëndës.

Pra, duhet vlerësuar atë që e kemi vënë në objektivi të vlerësimit, njohuritë, shkathtësitë, sjelljet dhe qëndrimet e fëmijës. Për vlerësimin e fëmijës në këtë moshë mund të përdoren forma dhe instrumente të ndryshme, si; vlerësimi për pjesëmarrje në aktivitete, punë grupore, bashkëpunim me të tjerët, kujdes për pastërtinë në klasë etj., që mund të kontrollohen/ maten në forma të ndryshme.

Për të gjitha llojet e vlerësimeve që duhet t'i bëhen fëmijës, pikë referimi janë rezultatet e lëndës, fushës kurrikulare dhe ato për kompetencave të shkallës së parë kurrikulare të parapara në Kurrikulën Bërthamë për Klasën Përgatitore dhe Arsimin Fillor dhe gjithashtu edhe udhëzimi i fundit administrativ i MASHT-it për vlerësim. Edukatori/ja, varësisht nga specifikat e tyre, hulumton gjetjen e formave më të përshtatshme për vlerësimin e arritjeve të tyre.

Qasja me kompetenca përveç që synon vlerësimin e arritjes së njohurive, synon të vlerësoj edhe atë se çka është në gjendje të bëjë fëmija, pra, vlerësimi i zbatimit praktik të njohurive të marra gjatë shkollimit. Në këtë kontekst është e nevojshme të bëhet vëzhgimi i vazhdueshëm i arritjeve të fëmijës dhe mbajtja e evidencës për qëllime dokumentimi dhe planifikimi të punës së mëtutjeshme. Vëzhgimi i punës në grupe dhe nismave individuale mund të vlerësohet edhe përmes teknikave të ndryshme siç është njëra nga to buletini i pjesëmarrjes apo lista e kontrollit, etj.

Është e rëndësishme që nga kjo moshë të kultivohet shprehia e vetëvlerësimit e cila mund të realizohet me mbajtjen e dosjeve të fëmijës, ku ruan punimet e veta reprezentative, si; për pjesëmarrjen në aktivitete të ndryshme dhe angazhime që lidhen me rezultatet e parapara për këtë moshë të fëmijëve.

Vlerësimi gjithnjë duhet të jetë i paanshëm, të ketë karakter motivues në mënyrë që fëmija të motivohet dhe të synojnë arritje sa më të larta.

## **Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore**

Krahas teksteve mësimore bazë sugjerohet që gjatë procesit mësimor, fëmijët dhe edukatorët/et të shfrytëzojnë edhe burime të tjera të njohurive siç janë: fletoret e punës, materiale tjera alternative, libra me ilustrime, broshurat, enciklopeditë për fëmijë, softuerët arsimorë. Gjithashtu sugjerohen vizitat e ndryshme monumenteve shoqërore, kulturore dhe natyrore.

Edukatorët/et mund të shfrytëzojnë literaturë të larmishme apo doracakë të ndryshëm për aktivitete me fëmijë, të përdorë material të ndryshme ricikluese nga të cilat mund të bëjë gjëra interesante me fëmijët. Gjithashtu, është shumë me rëndësi që fëmijët të inkurajohen dhe të udhëzohen për shfrytëzimin e burimeve të teknologjisë informative së bashku me prindërit me qëllim të arritjes së rezultateve të synuara.

# **FUSHA KURRIKULARE: EDUKATË FIZIKE, SPORTET DHE SHËNDETI**

**Kurrikula lëndore/programi mësimor**  
Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti

# **Kurrikula lëndore/programi mësimor**

## **Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti**

### **Përmbajtja**

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

## **Hyrja**

Veprimtaria fizike-lëvizore dhe aktivitetet sportive janë pjesë domethënëse e veprimtarisë edukative në fëmijëri të hershme dhe zë një hapësirë shumë të rëndësishme me ndikim të padiskutueshëm në zhvillimin psiko- fizik, social-emocional dhe shëndetësor të fëmijëve.

Fusha e zhvillimit fizik, sporti dhe shëndeti, do të përforcojë njohuritë e çdo fëmije dhe do t'i sigurojë atij/asaj përvoja, aftësi dhe njohuri të reja, të cilat do të zgjerojnë edhe më tej formimin kulturor, fizik e shëndetësor. Njohja, realizimi dhe vlerësimi i veprimtarisë fiziko-lëvizore e sportive nga të gjithë fëmijët është një formë e të vepruarit në grup, dhe ndikon në përforcimin e marrëdhënieve shoqërore dhe komunikuese.

Procesi i edukimit fizik dhe shëndetësor luan rol themelor në përgatitjen e fëmijëve për realizimin e veprimtarive kulturore-sportive dhe artistike. Ky proces merr rëndësi të veçantë veçanërisht në realizimin e aktiviteteve dhe veprimtarive të tjera të kombinuara me ato artistike, shoqërore e shëndetësore.

Organizimi dhe realizimi i kësaj lënde/fushe do t'i ndihmojë fëmijët të vlerësojnë efektet e pozitive të saj në shumë drejtime, jo vetëm në aspektin shëndetësor dhe fizik por edhe në atë të marrëdhënieve midis njëri tjetrit, në atë të zgjerimit të njohurive për kulturat e rajoneve e të vendeve të ndryshme, në atë të krijimit të një mjedisi më shoqëror

## **Qëllimi**

Qëllimi i fushës Edukatë fizike sporte dhe shëndeti është ofrimi i mundësive të gjithë fëmijëve për të përfituar njohuri, shkathtësi, shprehi, qëndrime, vlera dhe sjellje, të cilat do t'i përgatisin për jetë të shëndetshme psikofizike aktive. Fusha Edukatë fizike, sporte dhe shëndeti për këtë klase synon t'i arrije këto qëllime baze: të zhvillojë dhe të stimulojë shëndet të mire në aspektin fizik, psikologjik, emocional dhe shoqërorë; të formojë tek fëmija aftësi, shprehi lëvizore të vlefshme për të gjithë jetën dhe të formojë stil të jetës së shëndetshme.

## **Temat dhe rezultatet dhe të nxënit**

Fëmijët në klasën përgatitore arrijnë rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL) për temat e përcaktuara në tabelën e mëposhtme, të dala nga rezultatet e të nxënit të fushës (RNF) Edukatë fizike sporte dhe shëndeti, të shkallës së parë të kurrikulës (Shk1) në Kurrikulën bërthamë për arsimin e mesëm të ulët:



Koncepti	RNF, TEMA dhe RNL	
<b>Mirëqenie plotë fizike, psikike, emocionale dhe sociale</b>	<b>RNF: 1.</b> <b>1.Tregon për ndjenjat e tij /saj në situatat e jetës se përditshme dhe identifikon të drejtat dhe përgjegjësitë tij/saj.</b>	
	<b>Tema</b>	<b>Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)</b>
	<b>Njohja e vetes dhe e botës përreth</b>	Fëmija: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shpreh kreativitet me lëvizje fjalë dhe krijime të ndryshme</li> <li>• Shfaq emocione përmes lojës, aktiviteteve grupore, bashkëveprimit me edukator/e, fëmijët dhe të tjerët</li> <li>• Vlerëson ndjenjat e veta duke biseduar me të rriturit dhe bashkëmoshataret e vet</li> <li>• Mbështetë bashkëmoshataret dhe është i gatshëm për ndihmë</li> </ul>
	<b>Shëndeti dhe faktorët që ndi kojnë në shëndet</b>	Fëmija: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Njeh rëndësinë e shëndetit dhe faktorëve që ndikojnë në shëndet</li> <li>• Përshkruan në forma të ndryshme se si duket një person i shëndoshë</li> <li>• Njeh njerëzit/institucionet ku mund të kërkoj ndihmë</li> </ul>
<b>Kujdesi dhe siguria për veten dhe të tjerët</b>	Fëmija: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Dallon sjelljet e drejta në aktivitetet ku merr pjesë</li> <li>• Shpjegon sjelljen e drejtë e të gabuar në raste të ndryshme</li> <li>• Respekton rregullat gjatë lojërave dhe aktiviteteve të ndryshme në ambientet e shkollës/kopshtit dhe me gjerë</li> <li>• Njeh dhe respekton udhëzimet për përdorimin e mjeteve, rekuizitave dhe pajisjeve të ndryshme</li> </ul>	
<b>Zhvillimi i gjithanshëm dhe harmonik i trupit përmes aktiviteteve fizike dhe sportive</b>	<b>RNF: 2.</b> <b>1.Demonstron kombinime me lëvizje të ndryshme jo lokomotorë (tërheqje, shtytje, ekuilibrim, kthim, rrotullim etj), lokomotorë (ecje, vrapim, kërcim etj) dhe sporteve të tjera</b>  <b>2.Merr pjesë aktive duke zhvilluar shkathtësitë lëvizore nëpërmjet lojërave elementare dhe popullore .</b>	
	<b>Tema</b>	<b>Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)</b>

	<b>Lëvizjet elementare dhe koordinimi i tyre</b>	Fëmija: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Aplikon tekniken e duhur të frymëmarrjes gjatë aktiviteteve dhe ushtrimeve fizike nën drejtimin e edukatorit/es</li> <li>• Demonstron shkathtësi të lëvizjeve elementare gjatë kapjes dhe hedhjes së objekteve</li> <li>• Merr pjesë në lojëra elementare dhe demonstroi shkathtësi gjatë aktiviteteve në poligone të thjeshta</li> </ul>
	<b>Lojërat lëvizore dhe popullore</b>	Fëmija : <ul style="list-style-type: none"> <li>• Demonstron mënyra të ndryshme të ecjes, vrapimit, kërcimit, hedhjes etj</li> <li>• Kryen ushtrime themelore në terren, lartësi dhe distanca të ndryshme</li> <li>• Praktikon ushtrime të thjeshta ritmike me dhe pa mjete</li> </ul>
	<b>Lojërat dhe pushimi</b>	Fëmija : <ul style="list-style-type: none"> <li>• Praktikon lojëra dhe aktivitete fizike në bashkëpunim në çifte dhe grupe</li> <li>• Dallon shenjat e lodhjes dhe i menaxhon ato në mënyrën e duhur</li> <li>• Njeh dhe praktikon mënyrat e çlodhjes gjatë lojës dhe ushtrimeve</li> <li>• Përshtatë dhe përzgjedh veshjet sipas stinëve dhe aktiviteteve fizike</li> <li>• Aplikon masat higjienike para, gjatë dhe pas aktiviteteve fizike</li> <li>• Dallon qëndrimin e drejtë dhe jo të drejt të trupit dhe përpiqet të mbaj trupin drejt kur bartë objekte të ndryshme</li> </ul>
<b>Promovimi i stilit aktiv dhe të shëndetshëm të jetës</b>	<b>RNF: 3.</b> <b>1.Dallon mënyrën e drejtë të të ushqyerit sipas rutinës, ushqimin e shëndetshëm dhe jo të shëndetshëm dhe shpjegon ndikimin e të ushqyerit në rritje dhe në zhvillim</b> <b>2.Demonstron shkathtësi dhe shprehi për mirëmbajtjen e higjienës personale në shtëpi, në shkollë dhe mjedis</b>	
	<b>Tema</b>	<b>Rezultatet e të nxënës të lëndës (RNL)</b>

	Ushqimi shëndetshëm dhe kultura e të ushqyerit të drejtë	Fëmija: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Dallon llojet e ushqimeve që përdor në menynë e tij/saj</li> <li>• Shpjegon prejardhjen e ushqimeve që konsumon</li> <li>• Njeh produktet e ushqimit nga bota bimore dhe shtazore</li> </ul>
	Shëndeti dhe higjiena personale	Fëmija: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Tregon mënyrat e duhura për mirëmbajtjen e higjienës personale</li> <li>• Përzgjedhë dhe përshtatë veshjen sipas stinës, aktivitetit dhe veprimtarisë sportive që kryen</li> <li>• Mbronë dhe kujdeset për shëndetin dental dhe oral me mjetet e duhura</li> </ul>
Vetëdijesimi për ndikimin e përdorimit të substancave që krijojnë varshmëri	<b>RNF: 4.</b> <b>1. Identifikon produktet dhe mjetet të cilat nuk preken dhe nuk konsumohen dhe kupton se çfarë janë barnat dhe substancat e dëmshme</b>	
	<b>Tema</b>	<b>Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)</b>
	<b>Njohja dhe mbrojtja nga rreziqet e ndryshme</b>	Fëmija: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Njeh dhe dallon rreziqet në shkollë/kopsht, shtëpi dhe mjedisin ku jeton</li> <li>• Kupton rëndësinë e përdorimit të barnave për shëndetin e tij/saj</li> <li>• Njeh dhe kupton rreziqet nga përdorimi preparateve, pajisjeve të ndryshme në mjedisin ku jeton</li> </ul>
Edukimi mbi mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm	<b>RNF: 5.</b> <b>Kupton rëndësinë e zhvillimit të vazhdueshëm të aftësive fizike, dhe ndikimin e mjedisit në shëndetin dhe cilësinë e jetës</b>	
	<b>Tema</b>	<b>Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)</b>
	<b>Unë dhe mjedisi</b>	Fëmija: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Njeh konceptet elementare për mjedisin e shëndosh/pastër</li> <li>• Dallon mjediset e përshtatshme për aktivitetet fizike</li> <li>• Vlerëson rëndësinë e mjedisit të pastër gjatë aktiviteteve sportive</li> </ul>

## Udhëzime metodologjike

Për arritjen e rezultateve që përcaktohen në Fushën Edukatë fizike, Sporte dhe Shëndeti mund të përdoren metodat e ndryshme. Në kuadër të kësaj fokusi i edukatorit/es duhet të jetë në zbatimin e metodologjive të cilat sigurojnë të nxënit gjithëpërfshirës për të gjithë fëmijët.

Për arritjen e rezultateve të kompetencave të fushës përveç metodave të përbashkëta secila fushë mësimore ka edhe veçantitë e saja për organizimin e punës mësimore.

Në të gjitha rastet zbatimi i metodave dhe teknikave mësimore duhet të shoqërohet me përdorimin e materialeve dhe të mjeteve përkatëse didaktike duke pasur gjithnjë parasysh dhe sigurinë e fëmijëve.

Organizimi i mirë i procesit të të nxënit të kësaj fushe do të thotë që fëmijët të vendosen në situata konkrete praktike ku zhvillojnë dhe zbatojnë elementët lëvizore e sportive. Aktiviteti lëvizor, (loja dhe sporti) janë një punë serioze, që dominon shumicën e jetës së tyre në kopshte, shkolla dhe jashtë saj, duke u zënë pjesën më të madhe të kohës e të energjisë, duke krijuar aftësi, shkathtësi dhe formuar sjellje shoqërore, si kontribut themelor në kërkesën për rritjen e shpejtë dhe të shëndetshme.

Në aktivitetet e edukimit fizik duhet t'i vihet theks i veçantë në mbajtjen e higjienës, pjesëmarrja në to i mëson fëmijët se si të ruajnë pastërtinë dhe të kujdesen për higjienën e trupit gjatë dhe pas aktivitetit fizik. Gjatë këtyre aktiviteteve mësohen praktika të sigurta, të cilat, nëse ndiqen nga fëmijët gjatë gjithë jetës së tyre, do t'i parandalojnë ata nga sëmundjet e ndryshme.

Edukimi fizik dhe sportiv e gjen veten mjaft mirë si komponent i edukimit artistik përmes muzikës dhe vallëzimit të cilat së bashku ndihmojnë në zhvillimin dhe formim më të plotë të fëmijës.

## Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Trajtimi i çështjeve ndërkurrikulare në kuadër të fushës është një aspekt tjetër me shumë rëndësi pasi mundëson integrimin e fushave kurrikulare me qëllim të përkrahjes së fëmijëve që të kuptojnë dhe interpretojnë drejt proceset shoqërore dhe natyrore që ndodhin në shoqëri. Realizimi i çështjeve ndërkurrikulare do të ndihmojë zhvillimin dhe plotësimin e përmbajtjes së fushës për arritjen e të gjitha kompetencave të përcaktuara me Kornizën e Kurrikulit të Kosovës. Disa nga çështjet ndërkurrikulare që i ndihmojnë fëmijët në këtë nivel janë:

- **Globalizimi dhe ndërvarësia** (i referohet bashkëveprimit, kombinimit të aftësive dhe mundësive për të krijuar gjera të përbashkëta, kombinimit të përpjekjeve me të tjerët për të arritur suksese më të mëdha)
- **Edukimi për media** (i referohet përdorimit të mediave për sigurimin e informacioneve të reja dhe të drejta, krijimin dhe përdorimin e informatave,

komunikimin përmes mediave tradicionale dhe digjitale, kritiken ndaj mediave, gjuhën e mediave dhe ndikimin e saj në shoqëri, pritjet e qytetarëve nga mediat dhe përdorimit të drejtë dhe të sigurtë)

- **Zhvillimi personal dhe aftësitë për jetë** (edukimi për konsumim dhe kursim; respekti për vete dhe për të tjerët, toleranca, vetëpërmbytja, aftësia për marrëveshje; vetiniciativa dhe përgatitjet për të ardhmen).
- **Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm** (i referohet temave me rëndësi të përgjithshme të cilat ndikojnë në ndërgjegjësimin e nxënësve për një qëndrim aktiv ndaj çështjeve dhe dukurive mjedisore, në nivel lokal dhe global)

Për klasën përgatitore, temat thjeshtësohen duke pas parasysh moshën dhe mundësitë e fëmijëve. Edukatori/ja gjatë punës duhet t'i kushtoj kujdes çështjeve ndërkurrikulare që në fazën e planifikimit gjithmonë të analizojnë njësit mësimore me cilat çështjet ndërkurrikulare ndërlidhen në mendre që të sigurohet të nxëniti të integruar i cili synon përfshirjen e të gjitha aspekteve të rëndësishme shoqërore. Kjo arrihet përmes aktiviteteve, lojës të cilat ju mundësojnë fëmijëve të kuptojnë, eksplorojnë, ruajnë dhe mjedisin ku jetojnë.

## Udhëzime për vlerësim

Vlerësimi i arritjeve të fëmijëve mbështetet në rezultatet e programit edukativ sipas grup moshës së fëmijëve. Objektivi i vlerësimit nuk janë vetëm njohuritë dhe aftësitë, por edhe qëndrimet, vlerat dhe sjelljet e fëmijëve.

Edukatori/ja zhvillon një larmi mënyrash vlerësimi për shembull:

- Përdor fjalë e shprehje inkurajuese gjatë të nxëniti.
- Korrigjim me takt pedagogjik të lëvizjeve të gabuara.
- Përcaktimi i kohës së realizimit të veprimtarisë lëvizore mbi bazën e progresit individual;
- Distanca në metra e arritur nga veprimi lëvizor mbi bazën e progresit individual;
- Shenjat e mbingarkesës gjatë aktiviteteve fizike dhe lëvizore
- Përshkruan dhe komenton performancën e fëmijës për fushën e edukatës fizike në portfolion personale të fëmijës

Portfolio e fëmijës është mundësi vlerësimi dhe vetëvlerësimi, është një përmbledhje e performancës gjatë vitit për një fushë të caktuar. Ajo mund të përmbajë detyra tematike praktike, foto dhe CD të demonstrimit të aftësive lëvizore për linja të ndryshme të programit, angazhime

## Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Për realizimin me sukses të kompetencave në fushën mësimore Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti është e rëndësishme të përdoren burime të ndryshme mësimore që i motivojnë fëmijët dhe stimulojnë progresin e tyre në mënyre që të krijojnë shprehje dhe shkathtësi të nevojshme për jetë.

Për realizimin më të suksesshëm të fushës mësimore Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti duhet të përdoren një spektër i gjerë i burimeve mësimore, përfshirë tekstet, librat e aktiviteteve dhe të ushtrimeve, librat e punës, broshura, atlase, enciklopedi, softuerë arsimorë, projekte, studime të ndryshme, analiza dhe raporte të ndryshme të lëmit përkatës dhe libra të tjerë.

Edukatorët dhe fëmijët mund të angazhohen në hartimin dhe shfrytëzimin e materialeve mësimore, p.sh: rezultatet e projekteve të realizuara nga fëmijët mund të bëhen burime të vlefshme mësimore.

# **FUSHA KURRIKULARE: JETA DHE PUNA**

**Kurrikula lëndore/programi mësimor**  
Shkathtësi për jetë

# Kurrikula lëndore/programi mësimor

## Shkathësi për jetë

### **Përmbajtja**

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore



## **Hyrje**

Programi lëndor “Shkathëtesi për jete” për fushën kurrikulare “Jeta dhe Puna”, në klasën përgatitore synon që përmes lojës, si aktiviteti kryesor i të nxënës, të kontribuoj në arritjen e kompetencave të shkallës së parë dhe përmes përmbytjes të arrije edhe rezultatet e të nxënës për fushë.

Ky program synon që përmes temave fëmijët përfshihen me vetëdëshire dhe nxiten për të eksploruar mjedisin përreth.

Fëmijët e kësaj moshe vijnë nga mjedise të ndryshme familjare dhe me zhvillime jo të njëjtë, andaj është e rëndësishme që edhe programi lëndor “Shkathëtesi për jete” duhet të siguroj një shumëllojshmëri mundësishë të të nxënës.

Nëpërmjet situatave të thjeshta jetësore dhe aktiviteteve të ndryshme (lojëra, simulime etj), fëmija mëson me qasje aktive, ushtron punën praktike në shkollë, shtëpi dhe në mjedisin ku jeton, duke zhvilluar shkathëtesi për jete dhe punë.

## **Qëllimi**

Qëllimi i programit të lëndës “Shkathëtesi për Jete” është që fëmija nëpërmjet aktiviteteve të thjeshta praktike, të përshtatshme për moshën, të njoh materialet, t’i përzgjedhë dhe përdorë ato për funksione të ndryshme. Gjithashtu, përmes lojës të njoh, të manipuloj me pajisje teknike konkrete, të kryej veprimtari të thjeshta, të njoh funksionimin e tyre, si dhe të vetëdijesohet për kujdesin, mirëmbajtjen dhe mbrojtjen gjatë punës me to.

Programi, përmes koncepteve, ndihmon në përgatitjen e fëmijës si individë për jete dhe punë. Fëmija fillon të krijoj kulturë bashkëpunimi, kontribues dhe bashkëpjesëmarrës në ekonomisë familjare si dhe përgjegjës në ruajtjen dhe mirëmbajtjen e mjedisit jetësor (shtëpi, shkollë dhe vendin ku jeton).

## **Temat dhe rezultatet e të nxënës**

Nxënësit në klasën përgatitore arrijnë rezultatet e të nxënës të lëndës “Shkathëtesi për jete” (RNL) për temat e përcaktuara në tabelën e mëposhtme, të dala nga rezultatet e të nxënës të fushës (RNF) “Jeta dhe Puna”, të shkallës së parë të kurrikulës (SHk 1) në Kurrikulën Bërthamë për arsimin përgatitor dhe arsimin fillor:

<b>Koncepti</b>	<b>RNF, TEMA dhe RNL</b>	
<b>Zhvillimi personal</b>	<b>RNF: 1. Kuptimi dhe ushtrimi i punës praktike në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet</b>	
	<p>1.1 Përshkruan ndryshimet dhe ngjashmëritë ndërmjet aktiviteteve që bëhen në shtëpi, dhe në shkollë</p> <p>1.2. Zbaton veprimtari praktike të thjeshta në familje, në shtëpi dhe në klasë bazuar me detyrat e caktuara qartë nga mësuesi dhe nga prindërit.</p> <p>1.3. Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm- mbrojtja dhe ruajtja e natyrës dhe e mjedisit</p> <p>1.4. Përshkruan konceptet bazë të shoqërisë ,mjedisit dhe ekonomisë të familjare</p>	
	<b>Tema</b>	<b>Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)</b>
Mjedisi shtëpiak,kopshti dhe shkolla	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Përshkruan objektet e ndryshme të banimit si shtëpitë, pallatet dhe nepermes lojes simulon ndertimin e objekteve, orendive ...</li> <li>▪ Zhvillon veprimtarit dhe aktivitete në shtëpi, kopsht dhe shkollë dhe gjenë ngjashmëritë dhe dallimet në mes tyre</li> <li>▪ Realizon aktivitete në bashkëpunim me të tjerët përmes lojes (gatuan ushqime, rregullon ambientin, përgatit tryezën ...)</li> </ul>	
<b>Zhvillimi i bazuar në aktivitetet praktike manuale – punëdore.</b>	<p><b>RNF: 2. Ngritja e cilësive personale për jetë dhe punë</b></p> <p><b>2.1</b> Dallon ngjashmëritë dhe ndryshimet ndërmjet moshatareve në klasë dhe në shkollë,sa u përket talenteve, interesave dhe prirjeve për aktivitetet të ndryshme brenda dhe jashtë shkollës.</p> <p><b>3. Përdorimi i teknologjisë për jetën dhe punën e përditëshme</b></p> <p>3.1 Identifikon veglat ,paisjet dhe makinat e thjershta të ekonomisë familjare</p> <p>3.2 Identifikon veglat, mjetet dhe materialet adekuate për të punuar prodhime të thjeshta bazuar në iniciativa personale apo të propozuara nga mbikëqyrësi ose edukatori/ja</p> <p><b>6. Promovimi i kushteve të sigurta për jetë dhe për punë</b></p> <p>6.1 Identifikon rregullat për mbrojtje dhe siguri, dallon rreziqet në jetën e përditshme</p> <p><b>8. Komunikimi në/për jetë dhe punë</b></p> <p><b>8.1</b> Ndjek udhëzimet gjatë aktiviteteve të matjes, të shënimit, të prerjes së sigurt dhe të formësimit të materialeve të ndryshme</p>	

	<p><b>9. Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm-mbrojtja dhe ruajtja e natyrës dhe të mjedisit</b></p> <p>9.1 Identifikon, përshkruan dhe klasifikon material riciklues, bazë nga ekonomia familjare duke i dalluar dhe renditur për përdorim të mëtejshëm</p> <table border="1" data-bbox="375 283 1393 856"> <thead> <tr> <th data-bbox="375 283 565 342">Tema</th> <th data-bbox="565 283 1393 342">Rezultatet e tënxënimit të lëndës (RNL)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="375 342 565 619">Veglat, mjetet e punës dhe pajisjet elektronike</td> <td data-bbox="565 342 1393 619"> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Identifikon veglat dhe mjetet e punës, i përdor ato për lojëra dhe veprimtari të ndryshme në shtëpi apo kopsht-shkollë</li> <li>▪ Përshkruan funksionin e disa pajisjeve elektronike në jetën e përditshme dhe i përdor për punë (p.sh përdor PC për të komunikuar me të afërmit, vendos rrobat në rrobalarëse, printon vizatimet e tij nga printeri etj.)</li> </ul> </td> </tr> <tr> <td data-bbox="375 619 565 856">Materialët dhe riciklimi</td> <td data-bbox="565 619 1393 856"> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dallon materialet sipas llojit (p.sh pambuk, dru, lëkurë, tekstil) i përdor ato për krijimet e tij/saj</li> <li>▪ Krijon punime të ndryshme duke përdorur materiale ricikluese- (materiale natyrale, artificiale)</li> </ul> </td> </tr> </tbody> </table>	Tema	Rezultatet e tënxënimit të lëndës (RNL)	Veglat, mjetet e punës dhe pajisjet elektronike	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Identifikon veglat dhe mjetet e punës, i përdor ato për lojëra dhe veprimtari të ndryshme në shtëpi apo kopsht-shkollë</li> <li>▪ Përshkruan funksionin e disa pajisjeve elektronike në jetën e përditshme dhe i përdor për punë (p.sh përdor PC për të komunikuar me të afërmit, vendos rrobat në rrobalarëse, printon vizatimet e tij nga printeri etj.)</li> </ul>	Materialët dhe riciklimi	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dallon materialet sipas llojit (p.sh pambuk, dru, lëkurë, tekstil) i përdor ato për krijimet e tij/saj</li> <li>▪ Krijon punime të ndryshme duke përdorur materiale ricikluese- (materiale natyrale, artificiale)</li> </ul>
Tema	Rezultatet e tënxënimit të lëndës (RNL)						
Veglat, mjetet e punës dhe pajisjet elektronike	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Identifikon veglat dhe mjetet e punës, i përdor ato për lojëra dhe veprimtari të ndryshme në shtëpi apo kopsht-shkollë</li> <li>▪ Përshkruan funksionin e disa pajisjeve elektronike në jetën e përditshme dhe i përdor për punë (p.sh përdor PC për të komunikuar me të afërmit, vendos rrobat në rrobalarëse, printon vizatimet e tij nga printeri etj.)</li> </ul>						
Materialët dhe riciklimi	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dallon materialet sipas llojit (p.sh pambuk, dru, lëkurë, tekstil) i përdor ato për krijimet e tij/saj</li> <li>▪ Krijon punime të ndryshme duke përdorur materiale ricikluese- (materiale natyrale, artificiale)</li> </ul>						
<p><b>Këshillim dhe orientim në karrierë (Njohje me koncepte elementare, punë dhe profesion).</b></p> <p><b>Punëdore me elemente të teknologjisë (Teknologji duke përfshirë TIK-un)</b></p>	<p><b>RNF: 4. Përdorimi i TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme</b></p> <p>4.1. Përdor kompjuterin personal për komunikim fillestar</p> <p><b>7. Përgatitja për jetën profesionale dhe karrierën e ardhshme</b></p> <p>7.1. Identifikon aktivitetet dhe bartësit e aktiviteteve që zhvillohen në shtëpi, institucion parashkollor/shkollë dhe komunitet.</p> <p><b>8. Komunikimi në/për jetë dhe punë</b></p> <p><b>9. Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm-mbrojtja dhe ruajtja e natyrës dhe mjedisit</b></p> <p>9.1 Përshkruan konceptet bazë të shoqërisë, mjedisit dhe ekonomisë familjare</p> <table border="1" data-bbox="375 1375 1393 1675"> <thead> <tr> <th data-bbox="375 1375 587 1434">Tema</th> <th data-bbox="587 1375 1393 1434">Rezultatet e tënxënimit të lëndës (RNL)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="375 1434 587 1675">Profesionet</td> <td data-bbox="587 1434 1393 1675"> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Flet për disa profesione, indentifikon veglat(veshjet, makinat etj,) e punës që përdorin ata,</li> <li>▪ Luan lojë me role me profesione të ndryshme</li> <li>▪ Luan lojë me role duke imituar profesionistet, shfaq prirjet e tij/saj për profesionin e parapëlqyer</li> <li>▪ Përdor mjetet elektronike për punime të ndryshme</li> </ul> </td> </tr> </tbody> </table>	Tema	Rezultatet e tënxënimit të lëndës (RNL)	Profesionet	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Flet për disa profesione, indentifikon veglat(veshjet, makinat etj,) e punës që përdorin ata,</li> <li>▪ Luan lojë me role me profesione të ndryshme</li> <li>▪ Luan lojë me role duke imituar profesionistet, shfaq prirjet e tij/saj për profesionin e parapëlqyer</li> <li>▪ Përdor mjetet elektronike për punime të ndryshme</li> </ul>		
Tema	Rezultatet e tënxënimit të lëndës (RNL)						
Profesionet	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Flet për disa profesione, indentifikon veglat(veshjet, makinat etj,) e punës që përdorin ata,</li> <li>▪ Luan lojë me role me profesione të ndryshme</li> <li>▪ Luan lojë me role duke imituar profesionistet, shfaq prirjet e tij/saj për profesionin e parapëlqyer</li> <li>▪ Përdor mjetet elektronike për punime të ndryshme</li> </ul>						
<p><b>Puna dhe edukimi për ndërmarrësi</b></p> <p><b>Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm</b></p>	<p><b>RNF: 5. Ushtrimi i zhvillimit të ndërmarrësisë dhe planit të biznesit</b></p> <p>5.1 Përmes veprimeve praktike në ekonominë familjare kupton dhe përjeton faktorët që duhen marrë në konsideratë</p> <p><b>8. Komunikimi në /për jetë dhe punë</b></p> <p>8.1 Ndjek udhëzimet gjatë aktiviteteve të matjes, të shënimit, të prerjes së sigurt</p> <p><b>9. Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm mbrojtje dhe ruajtja e natyrës dhe e ambientit</b></p>						

9.1. Përshkruan konceptet bazë të shoqërisë, mjedisit dhe ekonomisë familjare	
<b>Tema</b>	<b>Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)</b>
Planifikimi i buxhetit familjar	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Simulon shitjen e gjëseneve, duke krijuar tregun dhe duke luajtur rolin e shitësit dhe blerësit</li> <li>▪ Dallon vlerën e parasë sipas formës dhe cakton dëshirën për blerje.</li> <li>▪ Jep ide për të krijuar listën e gjëseneve që duhen për punë duke arsyetuar rëndësinë e tyre</li> </ul>

## Udhëzime metodologjike

Metodologjitë e mësimdhënies të programit lëndor: “Shkathtësi për jetë“ të fushës “Jeta dhe Puna” në klasën përgatitore zbatojnë parimet e mësimdhënies të përcaktuara në Kurrikulën Bërthamë për të nxitur zhvillimin e kompetencat e të mësuarit.

Programi i lëndës: “Shkathtësi për jetë “ në këtë klasë zhvillohet i integruar me fushat të tjera si mësimi i gjuhës, matematikës, mësimi për mjedisin, formimi qytetar, për artet etj, por duke parë lidhjet e mundshme që tematikat e përzgjedhura nga edukatori/ja, ose nga tematikat që sugjerohen nga ai/ajo, mund të krijojnë lidhje midis rezultateve të nxënit që ofrojnë fushat e ndryshme dhe mund t’i zbatojnë ato në praktikë. Metodologjia e lëndës: “Shkathtësi për jetë “ në klasën përgatitore rekomandon punën në grupe dhe të mësuarit përmes projekteve, e cila integron dhe ndërthur brenda veti një tematikë për të gjitha fushat e zhvillimit, të paracaktuara në fushë dhe të mbështetura në standardet e zhvillimit dhe të mësuarit në fëmijërinë e hershme 0-6 vjeç.

Edukatori/ja përqëndohet kryesisht në këto aspekte:

- mësimdhënia përmes lojës dhe punëdorës, duke simuluar aktivitete për jetë dhe punë

- mësimdhënia dhe të nxënit bazuar në kompetenca;
- mësimdhënia me fëmijën në qendër;
- mësimdhënia dhe të nxënit e integruar;
- zhvillimi i temave ndërkurrikulare.
- zhvillimi i veprimtarive me arsimim të qëndrueshëm.

Edukatori/ja sugjerohet ta ndërtojë punën e saj mbi:

- përcaktimin e temës për të zhvilluar;
- listimin e metodave, teknikave dhe strategjive të cilat bazohen në ndërveprim;
- mundësimin në qasje në të gjitha mjetet më të domosdoshme që u nevojiten fëmijëve
- motivimin, nxitjen dhe lavdërimin e përhershëm të fëmijët;
- informimin dhe mbajtjen në lidhje të vazhdueshme me prindërit për progresin e fëmijëve të tyre

Themeli i marrëdhënieve edukator/e – fëmijë është ndërveprimi ku mjedisi, bashkëpunimi fëmijë - fëmijë, përdorimi i mjeteve dhe materialeve, stimulon gjithmonë një pjesëmarrjeje aktive të fëmijëve në të nxënë. Të nxënit përmes lojës dhe ushtrimet në grupe ose individuale, konsiderohen prioritet.

Lënda “Shkathtësi për jetë “ ka lidhje të forta dhe të afërta me lëndë tjera mësimore të klasës përgatitore të fushave tjera kurrikulare.

## **Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare**

Në kuadër të lëndës: “Shkathtësi për jetë “ një ndër qëllimet e rëndësishme të saj, duhet të jetë edhe përfshirja e çështjeve ndërkurrikulare, që do të ndihmojnë në arritjen e kompetencave kryesore të parapara me KB. Çështjet ndërkurrikulare që duhet të merren në konsideratë në këtë nivel, dhe që mund të trajtohen në vazhdimësi edhe në nivelet e tjera, janë:

- Edukimi për qytetari demokratike
- Edukimi për paqe
- Globalizimi dhe ndërvarësia
- Edukimi për media, dhe
- Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

Programi i lëndës: “Shkathtësi për jetë “ duhet realizuar në atë mënyrë që t`u mundësojë fëmijëve përvetësimin dhe zbatimin gradual të kompetencave kryesore të parapara në KB.

Organizimi i mësimit duhet të përqendrohet në atë se çka duhet të dinë dhe çka duhet të jenë në gjendje të bëjnë fëmijët. Ajo pasqyrohet përmes njohurive, shkathtësive, shprehive, por edhe përmes qëndrimeve dhe sjelljeve që ata duhet t`i reflektojnë.

## **Udhëzime për vlerësim**

Në përputhje me parimet e qasjes së të nxënit bazuar në kompetenca, vlerësimi konsiderohet si element i mësimdhënies i cili përqendrohet në nivelin e arritjes së kompetencave. Vlerësimi i përmbajtjes lidhet me zotërimin e njohurive dhe demonstrimin e aftësive nëpërmjet treguesve të besueshëm për progresin e fëmijëve. Gjatë vlerësimit edukatori/ja, duhet të ketë parasysh rezultatet e të nxënit për tema mësimore të klasës, duke i pasë parasysh rezultatet e shkallës.

Vlerësimi i arritjes së fëmijëve në klasën përgatitore realizohet nëpërmjet: evidencës së vlerësimeve të vazhdueshëm, vëzhgimi në klasë, punës praktike, në veçanti vlerësimi përmes portofolios, ndërsa raportimi i të arriturave të fëmijëve behët përmes përshkrimeve me komenteve konstruktive në formë narrative-si një vlerësim i zhvillimit psiko-social i fëmijut .

## **Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore**

Në këtë klasë edukatori/ja për realizimin e aktiviteteve me rezultate sa më të larta janë të lirë të përdorin të gjitha burimet (foto, ilustrime, fletushka, libra), mjetet dhe materialet (gjethe, gurë, druri, shishe plastike, fara të ndryshme, penje etj.) të cilat janë brenda kërkesave të moshës së fëmijëve dhe ndihmojnë arritjen e rezultateve dhe kompetencave të lëndës për këtë klasë. Gjithashtu, edukatori/ja preferohet të sugjeroj edhe prindërit të stimulojnë fëmijët e tyre të përdorin burime, mjete dhe materiale, edhe në përditshmëri në mënyre që të jetë vazhdimësi e punës të nisur nga edukatori/ja dhe bashkëpunim me familjen.